

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë,
Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni”, me profile
“Zhvillim Softwerësh”, “IT e Biznesit”, “Menaxhim dhe
Vlerësim Projektësh”, “Inovacion”

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Prof. Dr. Petraq Papajorgji
2. MSc. Aleksandër Pulla
3. MSc. Alda Osmëni
4. Gerajda Ujkashi (studente)

Maj 2020

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES VLERËSIMI TË BRENDSHËM

Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave ‘Teknologji Informacioni’, është riorganizim i programit të studimit Master i Shkencave në ‘Informatikë Ekonomike’, i miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, Nr. 666, datë 12.10.2018¹, duke u profilizuar si program i studimeve universitare të ciklit të dytë në fushën e teknologjisë së informacionit.

Në përputhje me Pikën 2 të UMASR Nr. 666, datë 12.10.2018, programi i studimit filloi veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019 dhe është në proces akreditimi për herë të parë. Programi ofrohet nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, njësi bazë në Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, sipas përcaktimeve të Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 529, datë 04.09.2018², ‘Për hapjen e njësisë kryesore ‘Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës’ në Universitetin Europian të Tiranës’.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademik (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë ‘Master i Shkencave’ në ‘Teknologji Informacioni’³, me profile:

- 1) Zhvillim Softwerësh;
- 2) IT e Biznesit;
- 3) Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh;
- 4) Inovacion;

Ky program ka si qëllim të përgatisë specialistë të aftë për menaxhimin e teknologjisë së informacionit në përgjithësi dhe proceset e zhvillimit të sistemeve të informacionit në veçanti. Mbajtësi i diplomës ka afësinë të identifikojë kërkesat për zgjidhje, dizenjojë, zhvillojë sisteme innovative dhe komplekse të informacionit si dhe të kryejë kërkime shkencore të avancuara në këtë fushë. Bazuar në rregulloren e programit të studimit, të diplomuarit formohen për profesionet/mundësi punësimi të tipit si në vijim:

- a) Personel IT, dizenjim software
- b) Personel IT, dizenjim aplikacionesh
- c) Administrator baza të të dhënave
- d) Personel IT, dizenjim dhe implementim rrjeta kompjuterike

¹ UMASR Nr. 666, dt. 12.10.2018 (Ref. Nr. 54)

² UMASR Nr. 529, dt. 04.09.2018 ‘Për hapjen e njësisë kryesore ‘Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës’ në Universitetin Europian të Tiranës’. (Ref. Nr. 54.2)

³ Model Diplome_Suplement (Ref. Nr. 15.1 – 15.4); Vendim Senati Nr. 18 Prot., dt. 17.12.2021 ‘Mbi mbylljen e disa profileve’. (Ref. Nr. 54. 6)

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Raporti është përgatitur nga një grup ekspertësh i ngritur me Urdhër Administrativ të Rektorit, konkretisht Nr. 15, datë 21.12.2020 dhe Nr. 02, datë 15.02.2021, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL, si dhe me Statutin dhe Rregulloren e UET. Në përzgjedhjen e anëtarëve të Grupit është mbajtur parasysh kompetenca profesionale, përvoja mësimdhënëse, aftësitë analizuuese, mundësitë për mbledhjen dhe për përpunimin e informacionit për të kryer një vlerësim të paanshëm, shkalla e nevojshme të njohjes së institucionit, si dhe profili individual profesional. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Në konsultim me personelin akademik dhe studentët, anëtarët e Grupit në analizën e tyre kanë vënë theksin në përmbajtjen akademike të programit, në cilësitë e personelit akademik përgjegjës për realizimin e tij, në vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion, si dhe në parametra të tjerë me rëndësi për procesin e akreditimit.

Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë udhëzimet e ASCAL-it, si edhe ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UET-it. Grupit i janë vënë në dispozicion dhe ka shfrytëzuar në mënyrë racionale të dhënat që nevojiten për procesin e akreditimit.

Ecuria e procesit është ndjekur nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, të cilët kanë asistuar GVB dhe kanë koordinuar procesin e mbledhjes së të dhënave. GVB ka zhvilluar takime të herëpashershme me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces, takime të fokusuar në orientimet e nevojshme në lidhje me procesin e hartimit të raportit të vlerësimit të brendshëm, udhëzuesit dhe template-t për shkrimin e raportit.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Teknologji Informacioni”, me profile: “Zhvillim Softwerësh”; “IT e Biznesit”; “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”; “Inovacion”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit është në harmoni me interesat kombëtare dhe synon nxitjen dhe respektimin e tyre, në përputhje me modelin e përzgjedhur si vizion të UET, modeli sipas së cilit universitetet janë në linjën e parë të respektimit të kodeve të sjelljes së mirë në të gjitha fushat ⁴ .
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit është hartuar me objektivin për pajisjen e studentëve me edukimin më të mirë për t’i shërbyer zhvillimit të tyre profesional dhe për të dhënë kontributin e tyre në eksplorimin në fushat e reja të shkencës. Programi është hartuar dhe zbatohet në përputhje me qëllimin, misionin dhe objektivat e institucionit për të përgatitur specialistë të kualifikuar dhe të aftë për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut edhe në zhvillimin perspektiv të tij. Programi i studimit ka për qëllim të ruajë dhe konsolidojë vlerat akademike e kulturore kombëtare ⁵ .
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit si edhe kërkesat e tregut të punës ⁶ . Programi i studimit ka objektiva të mirëpërcaktuara përsa i përket formimit të studentëve në atë program, të cilat i përfshijnë plotësisht dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të marrin studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit ⁷ dhe ka si objektiv të plotësojë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Studentët e diplomuar janë të aftë për t’u punësuar në tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar, por edhe për të krijuar vetë kompani dhe të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik lokal ose kombëtar.
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Programi i studimit i pajis studentët e diplomuar me njohuri të thelluara teorike dhe aftësim shkencor në fushën e tyre kërkimore ⁸ .

⁴ Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”, Vizioni, pika 9 (Ref. Nr. 3).

⁵ Referuar “Statuti UET”, Kreu I, Neni 6 (Ref. Nr. 2).

⁶ Referuar “Statuti UET”, Kreu I, Neni 6, pikat 1 dhe 2 (Ref. Nr. 2).

⁷ Referuar “Projekti 500+” (Ref. Nr. 47.1);

Referuar “Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve” (Ref. Nr. 17).

⁸ Referuar “Statuti UET”, Kreu IV, Neni 32, pika 2 (Ref. Nr. 2)

	Gjithashtu ky cikël studimesh shërben për të vazhduar studimet e ciklit të tretë ⁹ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2				
Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret		Vlerësimi		
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.		Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. dhe nga vlerësimi i kryer sipas standardeve shihet se programi i studimeve të ciklit të dytë në fjalë synon pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme të përshtatshme me fushën e veprimtarisë respektive ¹⁰ .		
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.		Drejtimit prioritar akademike janë të përcaktuara në dokumentet themelore të institucionit. UET mbetet i hapur ndaj diversifikimit të ofertës së tij akademike e shkencore dhe në drejtime të tjera që vlerësohen se kërkohen nga tregu i punës dhe UET ka mundësitë njerëzore e financiare për ti aplikuar ato. Zgjerimi i ofertës akademike, i vitit 2019 – 2020, është tregues i këtij parimi ¹¹ .		
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.		Evidentohet që programi i studimit emërtohet e organizohet si nga struktura dhe përmbajtja e tij në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit duke i vënë rëndësi këtyre profileve për të ofruar më të mirën e mundshme lidhur me to. Kurrikulat përpilohen konform drejtimeve akademike të UET duke përshtatur mjaft mirë kërkesat e tregut me programet e ofruara ¹² .		
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, trendet kombëtar dhe atyre globale të zhvillimit		Programi i studimit mbështetet në parimin e zhvillimit të një universiteti lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselence të specializuar në fushën e studimeve shoqërore-politike ¹³ . Programi është ndërtuar në përputhje me strategjinë e UET duke aplikuar eksperiencën më të mirë të universiteteve perëndimore ¹⁴ .		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁹ Referuar “Statuti UET”, Kreu IV, Neni 33, pika 4 (Ref. Nr. 2)

¹⁰ Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”; “2021-2025” (Ref. Nr. 3; 3.3).

¹¹ Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”; “2021-2025”, seksioni “Objektivat strategjike”, pika 3 (Ref. Nr. 3; 3.3).

¹² Referuar “Statuti UET”, Kreu IV, neni 30 (Ref. Nr. 2)

¹³ Referuar “Statuti UET”, Kreu I, neni 6, pika 1 (Ref. Nr. 2).

¹⁴ Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”; “2021-2025” seksioni “Prioritetet në procesin mësimor”, pika 4 (Ref. Nr. 3; 3.3).

Standardi I.3	
Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit ofron njohuri të harmonizuara nëpërmjet zhvillimit të lëndëve të formimit të përgjithshëm dhe të veçantë, të cilat sigurojnë njohuri të thelluara të ideve më të avancuara në lidhje me mekanizmat sasiorë e cilësorë që funksionojnë në një ekonomi treg¹⁵. Programi është hartuar dhe zbatohet në përputhje me qëllimin, misionin dhe objektivat e institucionit për të përgatitur specialistë të kualifikuar dhe të aftë për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut edhe në zhvillimin perspektiv të tij. Falë programit të hartuar me kujdes, synimi shpaloset i përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këtë program, që përfshin përfundimin e dijeve, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Për t’iu përshtatur kërkesave të tregut të punës institucioni kryen studime periodike. Studimi i tregut lokal e ndërkombëtar të punës në mënyrë të vazhdueshme që institucioni kryen shërben si një indikator real e mjaft i rëndësishëm si pikënisje e pikë mbështetje për orientim mbi hartimin e programit të studimit që ofrohet¹⁶. Institucioni kryen takime frekvente ku ndan me ish studentët mendimet mbi përvojat e tyre personale në tregun e punës dhe duke hulumtuar për sugjerime e përshtypje individuale e në grup për ndryshime, reformime e përmirësime të mundshme aty ku shfaqet nevoja për ndërhyrje e ndryshim. Nga të dhënat e analizuara ndër vite rezulton se pjesa më e madhe e studentëve pjesëmarrës në studim punësohen mbas mbarimit të ciklit të dytë të studimeve. Kjo lidhet edhe me vetë specifikën e programit¹⁷. Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në Teknologji Informacioni me profile ka si mision kryesor të përgatisë specialistë të nivelit të lartë, të aftë për të përballuar kërkesat e</p>

¹⁵ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 7)

¹⁶ Referuar “Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit” (Ref. Nr. 16);

Referuar “Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve” (Ref. Nr. 17)

¹⁷ Referuar “Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve” (Ref. Nr. 29)

<p>përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>tregut në drejtim të zgjidhjeve dhe menaxhimit softwerik të projekteve. Në këtë program studentët do të pajisen me dijet më inovative në këtë drejtim për t'i bërë të aftë të përdorin teknologjitë e reja të menaxhimit të të dhënave, të domosdoshmenë në të gjitha fushat e zhvillimit ekonomik e social¹⁸.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me kriteret e sistemit të Bolonjës ku mundësohet mobiliteti i studentëve mes universiteve¹⁹. Për hartimin e programit janë marrë parasysh programet e ofruara nga institucionet vendase dhe të huaja.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikrat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe në hartimin e tij janë marrë parasysh praktikrat më të mira të vendeve europiane²⁰.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi ndërthur aspektet teorike me ato praktike. Në kuadër të aftësimin profesional UET ka lidhur një sërë marrëveshjesh me shumë organizata biznesi si p.sh INSTAT, Balfin Group, Mikrotik, EHW, Albtelecom, Lufthansa Industry Solution etj²¹. Vlen të përmendet marrëveshja Nr.360 Prot. e datës 10.12.2019 me Lufthansa Industry Solution, tek e cila përcaktohet se kjo kompani do të ofrojë internship për një periudhë kohore të pacaktuar²².</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Programi është licensuar në gjuhën shqipe. Por, sipas Rregullores së UET, si pjesë e lëndëve të kategorisë C, departamenti mund të ofrojë lëndë “Honors course”. Këto lëndë propozohen dhe drejtohen nga pedagogë me grada dhe tituj, të cilat mund të ndryshojnë nga njëri vit në tjetrin, në varësi të ekspërtizës së personelit akademik të gatshëm për t'i zhvilluar. Këto kurse mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze²³. Propozimi për ndryshime në çdo rast vjen i argumentuar nga personi i interesuar. Ai shqyrtohet në Departament dhe nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave²⁴ dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit. Rishikimi mund të bëhet vetëm para fillimit të vitit akademik dhe jo në mes të vitit akademik apo pasi ai të ketë filluar. Rishikimi i programit mund të parashikojë bashkime lëndësh ose ndarje të tyre, por pa cenuar raportet e përcaktuara për secilën kategori disiplinash në program, rishikimin e krediteve,</p>

¹⁸ Referuar “Modeli i diplomës (Urdhëri i aprovimit-nuk ka); Modeli i Suplementit të Diplomës” (Ref. Nr. 15.1 – 15.4)

¹⁹ Referuar “Plani Strategjik për zhvillimin e programit” (Ref. Nr. 4);
Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”; “2021-2025” (Ref. Nr. 3; 3.3)

²⁰ Referuar “Ligji 80/2015 Per arsimin e larte ne RSH” (Ref. Nr. 53)

²¹ Referuar “Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikrat profesionale”; ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 5 (Ref. Nr. 32; Ref. Nr. 0.2)

²² Referuar “Marrëveshje bashkëpunimi UET dhe Lufthansa Industry Solution Nr. 360 Prot.” (Ref Nr. 34.11)

²³ Referuar “Rregullores së UET”, Kreu IV, neni 16, pika 3 (Ref. Nr. 5)

²⁴ Referuar “Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave” (Ref. Nr. 13)

	të lëndëve, të teksteve që do të përdoren por edhe të literaturës. Gjithsesi, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, UET krijon mundësinë që për studentët Erasmus, lëndë specifike të ofrohen në gjuhë të huaj ²⁵ .								
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Vlen të theksohet se një pjesë e dokumentacioni të UET ²⁶ gjendet në gjuhën angleze, por jo specifikisht për programin meqënëse programi është licensuar në gjuhën shqipe siç e theksuam në kriterin 7.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave” në “Teknologji Informacioni” me profile ofrohet nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Nga vlerësimi i kapaciteteve dhe burimeve arrihet në konkluzionin se institucioni plotëson standardet në programin e studimit ²⁷ . Aktualisht, në Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës janë të angazhuar 26 personel akademik efektiv, prej të cilëve 7 të kategorisë Profesor, 7 të kategorisë Lektor dhe 12 të kategorisë Asistent Lektor. Për sa i përket personelit akademik me kontratë, në total janë të angazhuar 25, prej të cilëve 9 të kategorisë Profesor, 11 të kategorisë Lektor dhe 5 të kategorisë Asistent Lektor.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit MSh “Teknologji Informacioni” me profile është një program i cili kombinon element si të fushës informatike ashtu edhe ekonomike. Konstatohet përputhje e plotë midis fushës së përgjithshme dhe specifike me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Kjo përputhshmëri evidentohet në të gjithë programet e ofruara nga Departamenti ²⁸ .
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të	Përputhshmëria garantohet në të dy njësitë, përgjegjëse dhe kryesore.

²⁵ Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”; “2021-2025”, seksioni “Prioritetet në bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar”, pika 3 (Ref. Nr. 3; 3.3)

²⁶ Referuar “Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë” (Ref. 30.2)

²⁷ Referuar “Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse” (Ref. Nr. 23)

²⁸ Referuar “Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse” (Ref. Nr. 26)

studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, institucioni nxit bashkëpunimin midis personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, duke siguruar një mënyrë të garantuar për të pasur marrëdhënie eficiente bashkëpunimi midis tyre në vazhdimësi ²⁹ .
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	GVB evidentoi se institucioni dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet për realizimin e objektivave të programeve të studimeve: duke siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë; apo organizuar trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit ³⁰ .
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Institucioni dhe konkretisht, njësi përgjegjëse për programin e studimit në periudha të vazhdueshme ka raportuar analitikisht përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. Kompanitë që janë anëtare të Bordeve të Punës pranë Departamenteve në UET, janë shprehur të hapura në bashkëpunim për internshipet, bordet e punës, leksionet e hapura dhe vizitat në kompani. Universiteti do të vijojë orientimin në bazë të kërkesave të tregut dhe në përputhje me strategjitë për zhvillimin kombëtar, duke mos e përjashtuar mundësinë e përditësimit të kurrikulave. Në vazhdimësi me zhvillimet studentore në këtë drejtim studimor edhe në programe të ngjashme, është në objektivat afatmesme dhe afatgjata të këtij programi studimi “Master i Shkencave”, që të pasurojë dhe përmirësojë ofertën akademike dhe të intensifikojë kërkimin shkencor në dimensione të lidhura

²⁹ Referuar “Rregullore e UET”, Neni 16, 17, 18, 21, 22 (Ref. Nr. 5);

Referuar “Dokumentet F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit” (Ref. Nr. 6);

Referuar “Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësisht profesional” (Ref. Nr. 38).

³⁰ Referuar “Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikave profesionale” (Ref. Nr. 32)

	me dobishmërinë dhe kontributin për zhvillimin e vendit. Referenca është e njëjtë me kriterin 2 të standartit I.5.			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	Në funksion të realizimit të praktikave profesionale, institucioni bashkëpunon me një sërë aktorësh dhe institucione. Aktualisht janë nënshkruar marrëveshje me aktorë si: Infosoft; Balfin shpk; INSTAT; E.H.W shpk; etj. Gjithashtu institucioni bashkëpunon dhe me aktorë e institucione të tjera, me të cilat pavarësisht se nuk ka marrëveshje të shkruara, kanë rënë dakord për të pranuar student për zhvillimin e praktikës profesionale ³¹ .			
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera ndërkombëtare për levizshmëri të stafit akademik, administrativ dhe studentëve ³² .			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Institucioni dhe konkretisht, njësia përgjegjëse për programin e studimit “Master i Shkencave” në periudha të vazhdueshme ka raportuar analitikisht përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve ³³ . Kompanitë që janë anëtare të Bordeve të Punës pranë Departamenteve në UET, janë shprehur të hapura në bashkëpunim për internshipet, bordet e punës, leksionet e hapura dhe vizitat në kompani. Universiteti do të vijojë orientimin në bazë të kërkesave të tregut dhe në përputhje me strategjitë për zhvillimin kombëtar, duke mos e përjashtuar mundësinë e përditësimit të kurrikulave. Në vazhdimësi me zhvillimet.			
Shkalla e përmbushjes së standartit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	UET fokusohet në hulumtimin shkencor si një pikë shumë e rëndësishme për ecurinë e mësimdhënies dhe avancimin në kualifikimin shkencor të stafit akademik ³⁴ . Veprimtaritë kërkimore përfshijnë studime, projekte, artikuj dhe veprimtari të tjera krijuese. Institucioni ofron grant për kërkimin shkencor për të stimuluar stafin akademik për veprimtari kërkimore shkencore.

³¹ Referuar “Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale”; ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabela 5 (Ref. Nr. 32; Ref. Nr. 0.2)

³² Referuar “Plani Strategjik për zhvillimin e programit” (Ref. Nr. 4);

Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”; “2015-2021” (Ref. Nr. 3; 3.3)

³⁰ Referuar “Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve” (Ref. Nr. 35)

³⁴ Referuar Statuti i UET, Kreu IV, neni 36 (Ref. Nr. 2)

	Institucioni mbështet financiarisht botimet shkencore në revista me faktor impakti, sikurse dhe promovon dhe mbështet mobilitetin e stafit ³⁵ .			
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	UET ka një qendër kërkimore që merret me kërkimin shkencor të institucionit ³⁶ . Gjithashtu ekziston një qendër kërkimore për çdo Fakultet në UET. Në rastin konkret për Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës është Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionit ³⁷ .			
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	UET promovon kërkimin shkencor të përvitshëm duke zhvilluar konferencën “Ditët e Studimeve Shqiptare” ³⁸ që synon të mbledhë studiues nga e gjithë bota e drejtuar nga mentorë kombëtarë dhe jo vetëm. Njëkohësisht ka një politikë shpërblyese për personat e angazhuar në veprimtari kërkimore shkencore. Botimi i revistave shkencore nga vetë Institucioni është një tregues tjetër i mbështetjes dhe promovimit të kërkimit shkencor.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Dokumentet themelore UET i kushtojnë një vënd të veçantë integritetit akademik dhe çështjeve etike. Për ndjekjen e ecurisë së veprimtarive kërkimore shkencore, përveç instrumenteve të mësipërm, UET ka në strukturën e tij pozicionin e Zëvendës Rektorit për Kërkimin Shkencor, i cili është personi përgjegjës për politikën e kërkimit shkencor.			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Referuar syllabuseve ³⁹ të lëndëve është një pikë, e cila synon të përfshijë studentët ekselentë në kërkimin shkencor. Konkretisht: Detyra e kursit mund të jetë: ese/komentar libri/detyrë praktike/detyrë grupi/pjesëmarrja në kërkimin. Pjesëmarrja në kërkimin shkencor vlen vetëm për studentët ekselentë dhe duhet të konfirmohet nga titullari i drejtimit shkencor, të vlerësohet prej tij me pikë (maksimumi 20) përkundrejt një produkti kërkimor në formën e një raporti me shkrim, i cili i dorëzohet pedagogut të lëndës. Njëkohësisht studentët e programit “Master i Shkencave” stimulohen të marrin pjesë në konferencën “Ditët e Studimeve Shqiptare” me punimin e tyre shkencor ose në bashkëpunim me personelin akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

³⁵ Referuar “Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit” (Ref. Nr 43.1)

³⁶ Referuar “Statuti i UET”, Kreu III, neni 20, pika 7 (Ref. Nr. 2)

³⁷ Referuar “Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse” (Ref. Nr. 23)

³⁸ Referuar “Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)” (Ref. Nr. 55)

³⁹ Referuar “Formati i Syllabusit Cikli i parë dhe i dytë” (Ref. Nr. 19.1)

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programi i studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve” organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënljgjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programet e studimit janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), bazuar në kuadrin ligjor në fuqi ⁴⁰ . Për një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë, sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti është 60 kredite.
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Vërehet se përmes strukturës së tij të hartuar synohet gjithashtu formimi i shprehive të veçanta në një larmi të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të programit, e cila dëshmohet edhe nga ofrimi i programit me profile ⁴¹ .
Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Objektivat e Programit të Studimit të ciklit të dytë, grupi i vlerësimit të brendshëm vendos në dukje se programi i studimit “Master i Shkencave” është përshtatur më së miri me strategjinë për përgatitjen e një studenti të mirëinformuar e të plotësuar për tregun e punës. Nga vlerësimi i kryer shihet se programi i studimeve të ciklit të dytë në fjalë synon pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Nga konstatimet e GVB rezulton se programi i studimit “Master i Shkencave” ka objektiva të mirëpërcaktuara përse i përket formimit të studentëve në atë program, të cilat i përfshijnë plotësisht dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të marrin studentët në përfundim të programit të studimit “Master i Shkencave” dhe që karakterizojnë profilin e programit për ti përgatitur ata më së miri lidhur me problematikat e ndryshme që studenti mund të ndeshë, ti orientojë mbi vendimmarrjen për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënljgjore.	GVB vlerëson programin e studimit si të hartuar në përputhje me të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënljgjore. Pra programi i studimit “Master i Shkencave” në “Teknologji Informacioni” me profile

⁴⁰ Referuar “Kurrikula e programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 14);

Referuar “Plani mësimor i programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 14.1)

⁴¹ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 7);

Referuar “Kurrikula e programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 14);

Referuar “Plani mësimor i programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 14.1)

	rezulton i ndërtuar duke respektuar më së miri të gjitha kërkesat, elementët dhe aktet e duhura ligjore e nënligjore ⁴² .			
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga puna e GVB evidentohet se organizimi dhe administrimi i programeve të studimeve është strukturuar shumë mire, ku mund të shihen mbi përmbajtjen e tyre njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të dytë të cilat japin informacionet e duhura e të përshtatshme për informim të detajuar: ⁴³ <ul style="list-style-type: none"> • mbi lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër; • ngarkesën mësimore, • orët në auditor, • frekuentimin/ ndjekjen e programit; • syllabuset e detajuara për secilën lëndë, • praktikat, • ushtrimet, • orët e laboratorit,etj 			
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Programi i studimit “Master i Shkencave” i ka të mirëpërcaktuara kreditet e temës së diplomës në kurrikulën e programit të studimit ⁴⁴ . Ndërkohë tek Rregullorja e diplomimit ⁴⁵ përcaktohen saktë aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Nga monitorimi i kryer mbi bazën e RVB evidentohet që njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush konform të gjithë rregullave të përcaktuara, detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin në përputhje me standartet ⁴⁶ .
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Grupi i vlerësimit të brendshëm konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush plotësisht detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Institucioni ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme të cilat ndihmojnë në realizimin e suksesshëm të këtij misioni.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit	Institucioni së bashku me organet drejtuese përkatëse ka synuar gjithnjë në punësimin e një stafi të kualifikuar, me një sfond përvojë të pasur akademik. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Gjithsesi lihet

⁴² Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 7)

⁴³ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 7)

⁴⁴ Referuar “Kurrikula e programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 14)

⁴⁵ Referuar “Dokument B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” (Ref. Nr. 10)

⁴⁶ Referuar “Dokument F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit” (Ref. Nr. 6)

<p>akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>vend për t'u përmendur fakti që ky drejtim profesional duke qenë i karakterit praktik i përthith shumë shpejt në treg të diplomuarit e saj e duke lënë pak hapësira për zhvillim në grada akademike sesa në ato praktike e profesionale sikurse janë certifikimet në rang kombëtar e ndërkombëtar të cilat përbëjnë një target fokus për këtë kategori⁴⁷. Personeli Akademik Efektiv (PAE) kundrejt Personelit Akademik me Kontratë (PAK), në nivel programi për 2020-2021 është 13 ku 11 prej tyre janë me gradë shkencore kundrejt 5 ku 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Por stafi i brendshëm akademik përmbush 77.98% kundrejt stafit akademik të jashtëm që përmbush 22.02% të ngarkesës totale mësimore⁴⁸.</p>			
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të brendshëm konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush plotësisht, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Institucioni ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme të cilat ndihmojnë në realizimin e suksesshëm të këtij misioni.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Për zhvillimin e praktikave profesionale është ngarkuar një pedagog i brendshëm i departamentit⁴⁹. Po ashtu UET ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me institucione të ndryshme dhe organizata të biznesit për zhvillimin e praktikës. Një shembull ilustrues është marrëveshja me Infosoftin për intershipin me studentët.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Koordinatori i programit të studimit, Prof. Dr. Mimoza Durrësi, është caktuar me vendim Nr. 96, datë 03.12.2018, të Dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Detyrat kryesore të koordinatorit përcaktohen në aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit, si edhe në aktet rregullatore të UET⁵⁰.</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Detyrat e koordinatorit të programit përcaktohen mjaft qartë detyrat e paracaktuara dhe raportimet që duhet të realizojë në përputhje me hierarkinë. Referenca e njëjtë me kriterin 6 të standartit II.2.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

⁴⁷ Referuar “Statuti i UET”, Kreu II, neni 15 pika 2.2 (Ref. Nr. 2)

⁴⁸ Referuar “Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit ndër vite” (Ref. Nr. 24);

Referuar “Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit” (Ref. Nr. 25)

⁴⁹ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu VI, neni 34 (Ref. Nr. 5)

⁵⁰ Referuar “Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit MSh Teknologji Informatikë” (Ref. Nr. 36);

Referuar “Dokumentimi F.IV - F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit” (Ref. Nr. 6)

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Komisioni i paracaktuar mbi procesin e vlerësimit të brendshëm mbi detyrë e RVB konstaton mirëfilli që njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimeve ⁵¹ .
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Nga vlerësimi i brendshëm i kryer mbi institucionin dhe programin e studimit “Master i Shkencave” në “Teknologji Informacioni” u evidentua që ky program respektivisht është i strukturuar si edhe i organizuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi aktualisht. Konkretisht programi është riorganizuar në pesë kategori disiplinash ⁵² . Disiplinat mësimore të ofruara në kategorinë A, B, D dhe E janë të detyrueshme. Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë, në kategorinë B disiplina të formimit karakterizues të programit, në kategorinë D praktika profesionale. Gjatë vitit të dytë të studimeve, studenti përgatit edhe temën e diplomës, mbrojtja e së cilës është kusht i domosdoshëm për diplomim dhe përbën detyrimin e përfshirë në kategorinë E. Në kategorinë C bëjnë pjesë disiplina të ngjashme dhe/ose integruese, të cilat janë profile me zgjedhje të lirë nga studenti
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Mund të shohim që programi i studimit “Master i Shkencave” në “Teknologji Informacioni” me profile është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në dy vite e katër semestra përkatëse respektive. Kreditet e çdo lënde mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore pune e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës). Kreditet e një disipline fitohen vetëm pas vlerësimit të studentit me notë kaluese ⁵³ .
Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Nga vlerësimi i kryer në rolin e GVB u konstatua që programi i studimit “Master i Shkencave” përmban planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. Pra, në plan evidentohen mjaft pastër orët mësimore, lëndët respektive për semester, tipologjitë, shpërndarja e orëve në leksion/seminar/detyrë kursi si edhe kreditet përkatëse. Në plan shfaqet qartë forma e vlerësimit të studentit e cila kryhet në varësi

⁵¹ Referuar “Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit” (Ref. Nr. 6)

⁵² Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 3 pika 1.1 (Ref. Nr. 7)

⁵³ Referuar “Statuti i UET”, Kreut IV, neni 29 (Ref. Nr. 2)

	<p>të tipologjisë së cilës i përket lënda⁵⁴. Në fillim të çdo semestri studentëve iu vihen në dispozicion programet për çdo lëndë që ofrohet. Këto programe depozitohen në librarinë e Universitetit, si dhe mund të publikohen në formën e broshurës nga UET-i, si dhe postohen në sistemin LMS⁵⁵.</p> <p>Departamenti organizon edhe aktivitetin e tutoriatit dhe të këshillimit akademik për studentët në përputhje me rregullat e përcaktuara. Grafiku i organizimit të këtij shërbimi publikohet në fillim të çdo semestri me kohëzgjatje normale.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit “Teknologji Informacioni” me profile reflekton qartë në përmbajtjen e tij të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që kanë të bëjnë me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Pra për cilindo student që kërkon të ndjekë studimet pranë UET procedurat që duhet të ndjekë janë të pasqyruara mjaft dukshëm si në rastin kur ai kërkon të pranohet, ashtu dhe në atë kur do të transferohet apo kur do të kryejë ekuivalentim të studimeve⁵⁶.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga procesi i vlerësimit vihet re se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Teknologji Informacioni” me profile përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë⁵⁷, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara⁵⁸. Në program evidentohet më së miri informacioni mbi lëndët bazë, lëndët formuese si edhe ato të profilit ku specifikohen respektivisht numri i saktë korrespondues i orëve të praktikave, orëve të seminareve apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit. Po ashtu edhe në syllabusin e lëndës shtjellohet i gjithë programi në formë të përmbledhur mbi tematikat javore që do të trajtohen përkatësisht në çdo javë, përmbajtja e shkurtuar e tyre, literature ku duhet të mbështetet student, qoftë për atë të detyruar ashtu edhe për atë të rekomanduar si edhe objektivat e qëllimi i lëndës. Po ashtu reflektohen format e vlerësimit dhe detyrimet për frekuentimin e lëndës.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Sipas Rregullores së UET, si pjesë e lëndëve të kategorisë C, departamenti mund të ofrojë lëndë “Honors Course”. Këto lëndë propozohen dhe drejtohen nga pedagogë me grada dhe tituj, të cilat mund të ndryshojnë nga njëri vit në tjetrin, në varësi të ekspertizës së personelit akademik të gatshëm për t’i zhvilluar. Këto kurse mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze. Çdo vit realizohen përpjekjet maksimale për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programeve të studimit “Master i Shkencave” ku përditësohen në frekuencë të përsëritur dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe</p>

⁵⁴ Referuar “Plani mësimor i programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr.14.1)

⁵⁵ Referuar “Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS” (Ref. Nr. 46.1)

⁵⁶ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, Kreu 2 (Ref. Nr. 7);

Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, Kreu 9 (Ref. Nr. 7)

⁵⁷ Referuar “Syllabuset e lëndëve të ofruara” (Ref. Nr. 19)

⁵⁸ Referuar “Formati i Syllabusit Cikli i parë dhe dytë” (Ref. Nr. 19.1)

	<p>arkivohet dosja e plotë me qëllim që programi të jetë në lartësinë e duhur dhe të konkurrojë tregun e arsimit. Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave⁵⁹, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Propozimi për ndryshime në çdo rast vjen i argumentuar nga personi i interesuar. Rishikimi i programit mund të parashikojë bashkime lëndësh ose ndarje të tyre, por pa cenuar raportet e përcaktuara për secilën kategori disiplinash në program, rishikimin e krediteve, të lëndëve, të teksteve që do të përdoren por edhe të literaturës. Nëse, pas rishikimit të programit të studimit, në Kategoritë A, B, C dhe D shtohen disiplina të reja, studenti që ka nisur studimet me programin e vjetër është i detyruar t'i frekuentojë ato nëse nuk ka plotësuar numrin e nevojshëm të krediteve në këto kategori. Në çdo rast, ndryshimet nuk mund të jenë të tilla që të devijojnë nga formimi i kërkuar për fushën përkatëse të studimit⁶⁰. Ndryshimet ruhen në gjuhën shqipe duke qenë se ky program studimi është i licensuar në gjuhën shqipe.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Pra janë shqyrtuar me imtësi e korrektësi ligjet dhe rregullorja përkatëse për secilën kategori për të përcaktuar drejtë ngarkesën e duhur mësimore⁶¹.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Institucioni së bashku me organet drejtuese përkatëse ka synuar që emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave të mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve në rajon dhe jashtë tij në një kohë sa më të shkurtër. Nga të dhënat e punësimit të studentëve vihet re se shumica e</p>

⁵⁹ Referuar “Dokumentit E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave” (Ref. Nr. 13)

⁶⁰ Referuar “Rregullore e UET”, neni 16, pika 3 (Ref. Nr. 5)

⁶¹ Referuar “Ligji 80/2015 Per arsimin e larte ne RSH” (Ref. Nr. 53)

	studentëve janë të punësuar me mbarimin e ciklit të dytë të studimit ⁶² .
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Përzgjedhja e lëndëve/moduleve përbërëse, shpërndarja e tyre në dy vite e katër semestra, vlerësimi në kredite përkatëse e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional sa më efikas të tij. Misioni i hartimit të këtij programi është realizimi i një blloku lëndësh që janë themeltare për specializimin e studentit në një fushë me zhvillime masivisht dinamike ⁶³ .
Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Teknologji Informacioni” me profile përmban një strukturë, lëndë dhe emërtimin e tyre, ngarkesë në kredite, raportin teori praktikë që janë në përputhje me profilin e programit të ciklit të dytë të studimit dhe të përafërta me programe të ngjashme ndërkombëtare. Kur programi është hartuar janë marrë modele programet simotra më në zë ndërkombëtare për të sjellë eksperiencën e tyre të suksesshme sa më pranë studentëve tanë ⁶⁴ .
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Në programin e studimit evidentohet ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik të cilat synojnë mundësinë mbi arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Referenca është e njëjtë me kriterin 3 të standartit II.4.
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Programet e lëndëve/moduleve përditësohen periodikisht. Duke qenë se teknologjia përparon me hapa galopantë është e pashmangshme dhe një kërkesë e vazhdueshme për rifreskim të literaturave të sugjeruara si ato të kategorisë së detyrueshme ashtu edhe ato të rekomanduara ⁶⁵ .
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	Falë punës së GVB vërehet se falë strukturimit, përzgjedhjes së kujdesshme e të mirëpërcaktuar të fondit të lëndëve të miratuar për këtë program është synuar më e mira për formimin e përgjithshëm dhe specifik të studentit ⁶⁶ .
Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi mund të ndryshojë për t’iu përshtatur kërkesave të tregut ⁶⁷ . Ky cikël studimi i jep mundësi studentit të vazhdojë ciklin e tretë të studimeve ⁶⁸ . Duke u konsultuar me bordin e punës ato studimin e tregut është bërë një filtrim i kujdesshëm për përmbajtjen strukturore të këtij programi në mënyrë që formimi i studentit të jetë konform kërkesave që tregu ofron në çdo nivel.
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse	Një faktor influencues mbi vendimmarrjen për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit “Master i Shkencave” dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse e gjejnë falë konsultave dhe konsiderimeve të

⁶² Referuar “Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve” (Ref. Nr. 29)

⁶³ Referuar ”Kurrikula e programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 14)

⁶⁴ Referuar “Plani mësimor i programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 14.1)

⁶⁵ Referuar “Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 45)

⁶⁶ Referuar ”Kurrikula e programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 14)

⁶⁷ Referuar “Statuti i UET”, Kreu IV, seksioni “Studimet universitare”, neni 30, pika 4 (Ref. Nr.2)

⁶⁸ Referuar “Statuti i UET”, Kreu IV, neni 33, pika 4 (Ref. Nr. 2)

konsultohen dhe marrin parasysht propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	propozimeve të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. Indikatorë të këtyre drejtimeve janë tregu i punës, bordi i punës, studimi i tregut rajonal dhe jo vetëm ku reflektimi për përshtatjen e përzgjedhjen mërzgjedhjen më eficiente të jetë sa më me tepër baza mbështetëse e analitike me përvojë të gjatë diktuese ⁶⁹ .			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Vlen të theksohet se programet e studimit të ciklit të dytë janë kombinimi i teorisë me praktikën që i pajisë studentët e programit “Master i Shkencave” me aftësi diagnostikuese për analiza empirike për kërkimin shkencor ⁷⁰ . Në këtë cikël studimi, studentët marrin njohuritë themelore për kërkimin shkencor, të cilat thellohen më tej në ciklin e tretë të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli punësohet sipas formave të parashikuara në statut dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore të aplikueshme ⁷¹ . Kontrata e punës lidhet mbështetur në Ligjin Nr. 8015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe në Kodin e Punës, i ndryshuar. Të drejtat dhe detyrimet e personelit, përcaktohen në kontratën e lidhur mes tij dhe UET ⁷² . Në bazë të vlerësimit të kryer nga GVB është evidentuar se institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren ku komisioni i mbledhur me kompetencë të plotë për përzgjedhje stafi interviston secilin kandidat të interesuar për punësim pasi ka shqyrtuar më parë dosjen e plotë të tij dorëzuar paraprakisht burimeve njerëzore. Ndërkohë, personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i Shkencave”, përmbush kërkesat ligjore në fuqi më së miri.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i	Nëpërmjet një personeli të kualifikuar mësimdhënës, drejtues, administrativ e mbështetës të lëndëve të këtij programi studimi synohet garantimi i një shërbimi cilësor bashkëkohor ndaj

⁶⁹ Referuar “Statuti i UET”, Kreu IV, nenit 30, pika 4 (Ref. Nr.2)

⁷⁰ Referuar “Statuti i UET”, Kreu IV, neni 32, pika 2 (Ref. Nr. 2)

⁷¹ Referuar “Statuti i UET”, Kreu V, neni 41, pika 3 (Ref. Nr. 2)

⁷² Referuar “Format dosje staf akademik me kohë të plotë” (Ref. Nr. 44.1);

Referuar “Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme” (Ref. Nr. 44.2)

<p>arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>studentëve të kësaj dege. Rekrutimi i personelit akademik mbështetet mbi eksperiencën në mësimdhënien universitare, grada/titulli shkencor dhe aktiviteti kërkimor shkencor e botues. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. Gjithsesi lihet vend për t’u përmendur fakti që për vetë specifikën e këtij programi studimi nevojitet që stafi akademik të ketë drejtim profesional, por duke qenë i karakterit praktik lë pak hapësira për zhvillim në grada akademike. Pra, personat e angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave”, që nuk kanë gradat shkencore kanë çertifikimet në rang kombëtar e ndërkombëtar, të cilat përbëjnë një target fokus për këtë kategori⁷³.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Në strategjinë e kërkimit shkencor pasqyrohet fryma/ filozofia e realizimit të synimeve kërkimore të UET. Materializimi i strategjisë realizohet nëpërmjet katër përbërësve themelorë: mekanizmave të zbatimit, të cilat përpunohen nga Departamentet; përpunimit të planeve të integruara që realizohet nga Dekanatet; procesit të monitorimit dhe vlerësimit që realizohet nga Senati Akademik; dhe financimit të projekteve një- dhe shumë-disiplinore që miratohen nga Bordi i Financimit të Veprimtarisë Kërkimore. UET-i siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore dhe angazhimin në hulumtim⁷⁴.</p> <p>Si pjesë e ristrukturimit të revistave shkencore dhe përmirësimit të vazhdueshëm të produktit të kërkimit shkencor, UET ofron trajnime për botimin dhe kryerjen e kërkimeve në grup për stafin akademik. Trajnimi është i organizuar në seminare tre-ditore që ofrohen në fund dhe fillim të kalendarit akademik. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është kompetent për modulet që mbulojnë. Fusha e tyre kërkimore është në përputhje me lëndët që zhvillojnë⁷⁵. Personeli akademik dhe drejtuesit akademikë kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e UET-it, këshillim për studentët, tutoriat dhe detyra administrative, sipas përcaktimeve në Statutin e UET-it dhe Kontratës së lidhur mes tyre dhe UET-it⁷⁶.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe</p>	<p>UET ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë organizata biznesi. Vlen të përmendet marrëveshja Nr.14 e datës 22.01.2018 me Infosoft Systems Shpk, tek e cila përcaktohet se kjo kompani: a) do të ofrojë internship për një periudhë kohore nga 6 muaj në 24 muaj b) përmirësimin e kurrikulës ekzistuese, përshtatjen e silabuse veçanërisht në pjesën aplikative, dhe angazhimin e stafit të Infosoft Group në pjesën aplikative në mësimdhënie c) angazhimin e stafit të Infosoft Systems Shpk, në mentorimin e</p>

⁷³ Referuar “Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit ndër vite” (Ref. Nr. 24)

⁷⁴ Referuar ”Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020”; “2021-2025” (Ref. Nr. 3.1; 3.2)

⁷⁵ Referuar “Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit ndër vite” (Ref. Nr. 24)

⁷⁶ Referuar “Statuti i UET”, Kreu IV, neni 42, pika 2 (Ref. Nr.2);

Referuar “Statuti i UET”, Kreu IV, neni 42, pika 3 (Ref. Nr.2)

veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	temave të diplomave të studentëve të masterit sëbashku me stafin akademik të UET. të cilat janë përmendur më sipër në kriteri 4 tek standartin I.5. Falë zhvillimit të intershipeve e praktikave me institucionet, kompanitë apo marrëveshjet me firma, kompani e biznese të rëndësishme për tregun e punës, studentëve u ofrohet një mundësi mjaft e mirë për të përfutur nga këto partneritete, për tu konsoliduar apo nënshkruar marrëveshje punësimi e rekrutimi për eficiencë pozitive ⁷⁷ .			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Sipas GVB evidentohet që institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. Në pamundësi për përballimin e ngarkesës akademike vetëm me staf të brendshëm ⁷⁸ , si edhe për të respektuar totalin e lejuar të orëve për zhvillim sipas akteve rregullatorë të UET, rekrutohet edhe staf i jashtëm akademik për ta zhvilluar ngarkesën mësimore e shmangur kështu mbingarkesën e performancë jo të kënaqshme. Njëkohësisht institucioni vë në dispozicion personelit të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë) ⁷⁹ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Rekomandimet dhe propozimet që vijnë nga studimi i tregut e punës dhe propozimeve e dhëna nga bashkëpunëtorët nga programi 500+, UET i përdor për të përmirësuar përmbajtjen e programit të studimit “Master i Shkencave“ duke u konsultuar dhe marrë parasysh propozimet në përputhje me trendet e fundit të tregut të punës ⁸⁰ .
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen,	Institucioni merr në konsideratë në mënyrë të vazhdueshme të gjitha rekomandimet e studentëve ⁸¹ . Përpara marrjes së vendimeve, institucionet drejtuese të UET konsultohen me strukturat e tyre për programet e studimit dhe marrin parasysh

⁷⁷ Referuar “Marrëveshja e bashkëpunimit mes UET dhe Infosoft Nr.14 .prot, datë 23.01.2018” (Ref. Nr. 34.2)

⁷⁸ Referuar “Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit” (Ref. Nr. 25)

⁷⁹ Referuar “Statuti i UET”, Kreu V, neni 45, pika 2 (Ref. Nr.2)

⁸⁰ Referuar “Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve” (Ref. Nr. 17)

⁸¹ Referuar “Statuti i UET, Kreu VII, neni 51, pika 6 (Ref. Nr. 2)

nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	rekomandimet e tyre për çdo ndryshim të mundshëm për përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës.			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	UET zhvillon takime të Bordeve të Tregut të Punës ⁸² me studentët e diplomuar, të cilët sjellin eksperiencën e tyre dhe janë të gatshëm të ndihmojnë institucionin për përmirësimin e programit studimore Master shkencor. Një pjesë e madhe janë rikthyer auditoreve të UET, në pozicionin e lektorëve për të sjellë eksperiencën e fituar nga praktika.			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Institucioni, ne baze te konsultimeve me institucionet e tjera publike dhe private me te cilat bashkepunon, sipas kerkesave te tregut te punes, perditeson dhe pershtat programin, ne perputhje me dokumentin udhezues rreth ndryshimit te kurrikules ⁸³ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Objektivat kryesorë dhe prioritetet e programit të studimit janë përcaktuar qartë në analizën e tregut të punës përpara hapjes së programit ⁸⁴ , të cilat janë në përputhje me objektivat e vendosura nga Institucioni. Konstatohet që programi i studimit `Master i Shkencave` identifikon dukshëm prioritetet dhe objektivat thelbësorë të studimit dhe kërkimit shkencor lidhur me objektivat kryesor të institucionit.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Politikat institucionale janë të fokusuar tek veprimtaria kërkimore shkencore, të cilat implementohen nga njësia kryesore. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, konkretisht Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë ⁸⁵ administron procesin mësimor, nxit frymën e bashkëpunimit të stafi akademik në projekte të ndryshme kërkimore dhe bashkërendon të gjithë veprimtarinë e mësimdhënies.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Siç e kemi përmendur edhe tek kriteri 5 tek standarti I.6, institucioni synon të angazhojë studentët në veprimtari shkencore kërkimore. Konkretisht: Pjesëmarrja në kërkimin shkencor vlen vetëm për studentët ekselentë dhe duhet të konfirmohet nga titullari i drejtimit shkencor, të vlerësohet prej tij me pikë (maksimumi 20) përkundrejt një produkti kërkimor në formën e një raporti me shkrim, i cili i dorëzohet pedagogut të lëndës.

⁸² Referuar “Komunikimi i integruar i marketingut” (Ref. Nr. 51)

⁸³ Studimi I tregut përpara hapjes së programit (Ref. Nr. 16); Studimi periodik I tregut të punës (Ref. Nr. 17)

⁸⁴ Referuar “Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe aftësimit profesional” (Ref. Nr. 38)

⁸⁵ Referuar “Dokumentet F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit” (Ref. Nr. 6)

	Njëkohësisht studentët e programit “Master i Shkencave” stimulohen të marrin pjesë në konferencën “Ditët e Studimeve Shqiptare” me punimin e tyre shkencor ose në bashkëpunim me personelin akademik.			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Referuar veprimtarisë kërkimore shkencore mund të shprehemi se ky program studimi është në përputhje me politikat studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Veprimtaria kërkimore shkencore në UET e aktivitetet studimore, mbështetet financiarisht nga UET, i cili administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. Në UET, aktiviteti kërkimor financohet nga një sistem i dyfishtë: burimet e brendshme dhe donacionet/financimet nga jashtë. UET vendosë në dispozicion të stafit akademik një fond kërkimor tek i cili kërkuesit mund të aplikojnë për mbështetje për ndërmarrjen e projekteve kërkimore ose për shpërblim pas publikimit në revista dhe libra të botuara nga shtëpi botuese me reputacion ndërkombëtar në akademi. Fondet e UET mbështesin Njësitë bazë kërkimore për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore shkencore ⁸⁶ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8	
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Evidentohet se UET ka krijuar një mjedis motivues të kërkimit shkencor për personelin akademik dhe studentët. Njëkohësisht institucioni ka fusha të mëdha kërkimore që emërtohen si Projekteve të Mëdha Kërkimore (PMK). Institucioni ka siguruar bashkëpunim me një sërë institucione partnere në projekte shkencore ndërkombëtare ⁸⁷ .
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	UET synon të konsolidojë identitetin e universitetit si qendër e prodhimit të dijes në Shqipëri e të transformohet nga një institucion i arsimit të lartë i fokusuar në mësimdhënie, në një institucion elitare kërkimor, produkti kërkimor i të cilit kërkohet nga tregu dhe përmirëson në vazhdimësi mësimdhënien dhe eksperiencën studentore në UET. Për ta arritur këtë gjë UET angazhon stafin akademik në veprimtari kërkimore shkencore, për të cilët ofron edhe grant kërkimor ⁸⁸ . Gjithashtu mbështet studentët në përfshirjen e tyre në studime shkencore.

⁸⁶ Referuar “Strategjia e kërkimit shkencor në UET (2017-2020)”; “2021-2025” (Ref. Nr. 3.1; 3.2)

⁸⁷ Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”; “2021-2025” (Ref. Nr. 3; 3.3).

⁸⁸ Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”; “2021-2023”, prioriteti nr. VI (Ref. Nr. 3; 3.3); Referuar “Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit” (Ref. Nr. 43)

<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Referuar dokumentit “Strategjia e kerkimit shkencor“, pika 10 UET synon ta konsolidojë DSSH⁸⁹ si ‘conference of record’ për zhvillimet në hapësirën shqiptare që DSSH të konsolidohet si konferenca më prestigjioze në Shqipëri dhe të pranohet si e tillë edhe nga komuniteti shkencor ndërkombëtar ajo aplikon standardet e mëposhtme: Tërësia e këtyre standardeve, në kohë, do të bëjë që DSSH të krijojë një profil të pakonkurueshëm shkencor në hapësirën shqiptare, i cili do të forcojë më tepër karakterin shkencor të UET dhe do të lehtësojë ndërkombëtarizimin e kerkimit shkencor në UET.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p>Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Institucioni organizon trajnime të ndryshme dhe harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme, të larmishme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve⁹⁰. Duke u mbështetur në syllabuset e lëndëve⁹¹ shihet se reflektohet qartë natyra e pasur e metodave që alternohen e vihen në përdorim për realizimin eficient të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Personeli akademik dhe ndihmës akademik i nënshtrohet në mënyrë periodike trajnimeve, testeve dhe vlerësimeve prej strukturave përgjegjëse në institucion për identifikimin dhe vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Pra në këtë mënyrë</p>

⁸⁹ Referuar “Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)” (Ref. Nr. 55)

⁹⁰ Referuar “Dokumentit A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës” (Ref. Nr. 39);

⁹¹ Referuar “Syllabuset e lëndëve të ofruara”(Ref. Nr. 19)

	inkurajohet dhe nxirret në pah dëshira dhe tendenca për të sjell risi e përparim në formën e përcjelljes së dijes drejt studentit ⁹² .			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Institucioni UET për të ruajtur cilësinë në mësimdhënie dhe kënaqësinë e studentit mbi shërbimin e ofruar garanton përfshirjen e studentëve ⁹³ në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. Çdo vit, çdo semestër grupi i punës për kontrollin e cilësisë KSBC realizon fokus grupe, anketime e departamenti nga ana tjetër kryen takime me bordin e punës për të mbledhur informacion të nevojshëm për tu njohur me problematikat, sugjerimet si edhe pikat e forta të metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve e mënyrës së organizimit të rëve mësimore ⁹⁴ .			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Përfshirja e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie në mënyrë periodike, në fund të çdo semestri sjell që rezultatet e vlerësimit të përfuara të bëhen publike. Në përfundim të secilit monitorim hartohet një raport individual dhe një i përgjithshëm për secilin pedagog ku ai vihet në dijeni për rezultatin e marrë nga vlerësimi i studentëve ⁹⁵ .			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	Strategjia e ndjekur për monitorimin e vlerësimit dhe rezultateve të marra nga institucioni, nëpërmjet mekanizmave të tij specifike, promovon shembujt të praktikave të mira, frytdhënëse të cilat nxitin dhe inkurajojnë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë të mësimdhënies ⁹⁶ . Janë pikërisht këto politika që pasqyrojnë realitetin e situatave të mësimdhënies e mban në koherencë institucionin me problematikat, me avantazhet e ndihmon në sugjerime për pedagogë të caktuar apo për promovimin e punës së tyre në vazhdimësi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e	Nëse do të ndaleshim tek format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve nga pedagogët evidentohen që janë saktësisht leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/estetë,

⁹² Referuar “Statuti i UET”, Kreut V, neni 44, pika 3 (Ref. Nr. 2);

Referuar “G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performances së personelit akademik” (Ref. Nr. 41)

⁹³ Referuar “G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët” (Ref. Nr. 40)

⁹⁴ Referuar “Statuti i UET”, Kreut VII, neni 50, pika 3 (Ref. Nr. 2)

⁹⁵ Referuar “Statuti i UET”, Kreut I, neni 11, pika 3 (Ref. Nr. 2);

Referuar “G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët” (Ref. Nr. 40)

⁹⁶ Referuar “Statuti i UET”, Kreut V, neni 45 pika 5 (Ref. Nr. 2)

<p>klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni⁹⁷. Në këtë program studimi njohuritë e marra kontrollohen vazhdimisht. Në këtë mënyrë studentët kanë mundësi të rikuperojnë pjesët që nuk kuptojnë përpara përfundimit të lëndës. Kontrolli i njohurive në secilën lëndë bëhet në përputhje me tipologjinë e lëndës.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Në përputhje dhe përshtatshmëri me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Stafi akademik përkrah sugjerimet dhe mënyrat e mundshme të shfrytëzueshme e të sugjeruara për ta përcjellë sa më qartë e pranë studentit informacionin e dijen⁹⁸.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësit. Stafi akademik qëndron gjithnjë i gatshëm për të përqafuar qasjet më të reja të formateve të kompetencave didaktike duke ofruar kështu mësimdhënie në nivel bashkëkohor⁹⁹.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Standardet e menaxhimit të burimeve njerëzore, të personelit akademik dhe atij mbështetës përmbushen, jo vetëm në drejtim të zbatimit të procedurave ligjore të rekrutimit, por edhe në drejtim të zhvillimit dhe rritjes profesionale me qëllim përmbushjen e objektivave të programit¹⁰⁰. Personeli akademik i përfshirë në mësimdhënie është i aftë në shtjellimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit respektiv.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Studentët angazhohen për të dhënë mendimet e sugjerimet e tyre. Mësimdhënia bashkëkohore kërkon planifikim të mirëfilltë të materialit mësimor, metodologjisë mësimore dhe teknikave që do të përdoren për të arritur objektivat mësimor dhe synimet e targetizuara. Personeli akademik përmirëson format e metodat e mësimdhënies falë angazhimit të studentëve në këtë proces¹⁰¹.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Personeli akademik sikurse e ka të përcaktuar edhe në syllabusin e lëndës, përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë</p>

⁹⁷ Referuar "Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni" (Ref. Nr. 7)

⁹⁸ Referuar "Rregullore e UET", Kreu IV, neni 18, pika 1 (Ref. Nr. 5)

⁹⁹ Referuar "Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit" (Ref. Nr. 43)

¹⁰⁰ Referuar "CV e stafit akademik të programit të studimit" (Ref. Nr.20)

¹⁰¹ Referuar "Rregullore e UET", Kreu X, neni 42, pika f, (Ref. Nr.5)

	tërheqëse orët e mësimit dhe duke shtuar ndërveprimin gjatë zhvillimit të orëve mësimore ¹⁰² .			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Falë punës së realizuar nga GVB eventohet se një gërshetim metodash dhe formash të mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke mundur në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. Ky interaktivitet intensifikohet në zhvillimin e detyrës së kursit, e cila zhvillohet në grup për të nxitur dhe zhvilluar bashkëpunimin tek studentët. Personeli akademik nëpërmjet rasteve të studimit synon të nxisë të menduarit kritik tek studentët. Njëkohësisht specifika e programit ¹⁰³ mundëson që ata të bashkëpunojnë online në ekipe virtuale të punës për zhvillimin e kodeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godinat janë rikonstruktuar dhe mobiluar së fundmi, me sistem kondicionimi dhe sistem wireless. Sallat e leksionit janë organizuar në formë amfiteatri dhe me sistem fonie. Çdo sallë mësimore është e pajisur me PC dhe projektor. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Gjithashtu edhe biblioteka funksionon me orar të gjatë dhe ofron kushte të mira dhe një fond të pasur botimesh hard copy dhe elektronike, në gjuhën shqip dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore. Personeli akademik i brendshëm është i akomoduar në zyra dyshe. Përgjegjësit e departamenteve, dekanët, zv. Rektorët dhe drejtuesit e tjerë janë akomoduar në zyra individuale. Në dispozicion të departamenteve janë dhe sallat e mbledhjeve ¹⁰⁴ .
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	UET ka në përdorim laboratorë mësimorë Informatike, të cilat janë të pajisura me PC, video projektor dhe mjete të tjera audio vizive, të cilat janë përshtatshme në raport me numrin e përgjithshëm të studentëve që i përdorin ato sikurse dhe janë të përshtatshme dhe në përputhje me qëllimet e programit. Të gjitha sallat në të cilat zhvillohen si leksionet ashtu edhe

¹⁰² Referuar “Syllabuset e lëndëve të ofruara” (Ref. Nr.19)

¹⁰³ Referuar “Kurrikula e programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 14)

¹⁰⁴ Referuar “Infrastruktura në funksion të programeve të studimit” (Ref. Nr. 42)

	<p>seminaret janë të pajisura me PC dhe videoprojektor, të cilat i vijnë në ndihmë si studentëve ashtu edhe stafit akademik. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit III.3.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Të gjithë laboratorët në UET janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin mjaft modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit, instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale. Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit III.3.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Për realizimin e programeve biblioteka zotëron gjithsej 6005 tituj të disponueshëm për studentët, nga këto në shqip janë 4634 tituj dhe në gjuhë të huaj 1371. Për programet e studimit, në bibliotekë gjenden shumë tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse bashkëkohore dhe në pjesën më të madhe të shkruar nga autorë të huaj të njohur ndërkombëtarisht në shkollat më të degjuara. Biblioteka e UET furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Institucioni mbështet gjetjen e burimeve on-line të kërkuara nga pedagogët dhe studentët. Botimet periodike në total janë 162, nga këto 102 janë në shqip dhe 60 janë në gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht). Literatura bazë dhe ndihmëse e studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit¹⁰⁵.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Një nga synimet dhe detyrat kryesore të Bibliotekës është pasurimi i fondit të saj. Pasurimi i fondit të bibliotekës është bërë dhe vazhdon të bëhet përmes këtyre rrugëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Blerja në fillim të çdo fillim viti akademik i një numri të konsiderueshëm teksteve universitare dhe librash të reja që janë pjesë e kurrikulave shkollore si tekstet bazë ose si literaturë e rekomanduar; (b) Blerja në Panairin Kombëtar të Librit në nëntor të çdo viti i botimeve më të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me procesin mësimor; (c) Përkthimi dhe botimi nga UET Press-it i shumë teksteve (përfshirë tekste universitare dhe monografive shkencore që kanë për autorë pedagogë të UET-it, studiues të tjerë shqiptarë dhe autorë të huaj, klasikë dhe bashkëkohore. Këtu bëjnë pjesë edhe koleksionet e plota të të gjitha revistave shkencore që janë botuar dhe botohen nga ky universitet, si Polis, Economicus, Jus dhe Justicia dhe Sociological Analysis dhe Educatio. (d) Porosive dhe blerja online në Amazon.com e botimeve të rëndësishme dhe nga më të fundit në gjuhën angleze në ato fusha të shkencës me të cilat identifikohet me së miri ekspertiza e UET. (e) Të dhuruara nga organizata e shoqata të ndryshme, ambasada të huaja, individë dhe fondacione të ndryshme. <p>Një vend të veçantë në fondin e Bibliotekës së UET-it zënë</p>

¹⁰⁵ Referuar “Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 45)

	<p>titujt e shumtë akademikë (kryesisht tekste bazë dhe monografi) të botuara nga UET-Press, të cilat kanë autorë shqiptarë ose janë përkthime të disa prej botimeve më të mira dhe më të fundit të Universitetit të Oksfordit të botuara në shqip nga UET Press.</p> <p>Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit IV.3.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Gjithashtu janë kryer abonime në biblioteka virtuale, dhe revista shkencore në hard copy, të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik mijëra tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë, ku rendisim: Sage, Ebsco (abonim 5-vjeçar), Questia; kurse revista shkencore të huaja tituj si më poshtë:¹⁰⁶</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Harvard Business Review 2. The Economist 3. Foreign affairs 4. Commentaire 5. The Nations Interest 6. The American Interest 7. Educational Leadership etj.
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>UET disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Çdo sallë është e pajisur me PC dhe projektor të cilat shfrytëzohen nga studentët për realizimin e diplomave apo detyrave të kursit. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor “Master i Shkencave”. Studenti mund të punojë në Bibliotekë ose në sallën e internetit për detyrat e kursit apo punimin e diplomës që duhet të shkruajë.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Lidhur me sistemin Learning Management System, një tjetër aspekt si funksion i mësimdhënies, të cilin personeli akademik e shfrytëzon për shpërndarjen e informacionit dhe tejçimin e dijeve tek student në mënyrë sa më efiakse është edhe përdorimi i platformës on-line (e-learning) dhe mbështetja apo edhe nxitja e personelit akademik e studentëve po ashtu për përdorimin e tyre. Për këtë përdoren platformat LMS dhe UMIS¹⁰⁷.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Pranë institucionit UET vërehet një funksionim i akorduar nga personeli akademik dhe studentët në shfrytëzimin e sistemeve të komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar. Duke ndjekur këtë rrugë përmes platformave sikurse janë LMS apo UMIS realizohet një komunikim në koherencë e i suksesshëm mes palëve. Çdo vit kryhen trajnime të vazhdueshme për përdorimin e këtyre platformave në mënyrë që të ketë ecuri pozitive të hulumtimit dhe shfrytëzimit të tyre¹⁰⁸.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Një tjetër detyrë që i ngarkohet personelit akademik është edhe orientimi i studentëve në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asistimi dhe mbështetja në zhvillimin e tyre. Stafi akademik kryen seanca metodologjike prej 10 javësh në semestrin e dytë ku ai njeht hap pas hapi procedurën , teknikat e metodikën që studentit do të duhet të</p>

¹⁰⁶ Referuar “Infrastruktura në funksion të programeve të studimit” (Ref. Nr. 42)

¹⁰⁷ Referuar “Statuti i UET”, Kreu VII, neni 53, pika 5 (Ref. Nr. 2)

¹⁰⁸ Referuar “Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS” (Ref. Nr. 46)

	ndjekë për të realizuar punimin e një diplome ¹⁰⁹ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	UET ofron trajnime për botimin dhe kryerjen e kërkimeve në grup për stafin akademik. Trajnimi është i organizuar në seminare tre-ditore që ofrohen në fund dhe fillim të kalendarit akademik. Trajnimet e stafit për mësimdhënie dhe kërkim shkencor janë zhvilluar nga institucioni me qëllim kualifikimin dhe avancimin e qasjes së stafit akademik përkundrejt mësimdhënies, këshillimit të karrierës dhe kërkimit shkencor ¹¹⁰ .
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron ¹¹¹ . Ai përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me parimet dhe kriteret e vendosura për të garantuar që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm. Gjithashtu përgjegjësi i departamentit miraton silabuset e hartuara, bën vlerësimin e mësimdhënies, qoftë duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimi nga personeli akademik, qoftë duke inkurajuar studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar, në mbledhjet e hapura me ta, por jo vetëm. Stafi dhe studentët e dinë që do i nënshtrohen një procesi të vlerësimit të mësimdhënies ¹¹² , gjë e cila rrit vetëdijen për cilësinë e mësimdhënies
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Nga monitorimi i kryer prej GVB shihet që strukturat dhe njësitë përgjegjëse përgjithësisht janë të hapura e suportuese dhe mbështesin masivisht eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Falë përkrahjes nga këto struktura bëhet e mundur përcjellja e dijeve konform teknikave më të reja, bashkëkohore e risi ku student të mund ta përthithë më lehtë infomacionin e përçar ¹¹³ .
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit	Nga puna e kryer si GVB dua të nxjerr në pah se personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Dy objektiva

¹⁰⁹ Referuar “Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” (Ref. Nr.10)

¹¹⁰ Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”; “2021-2025”, pika I (Ref. Nr. 3; 3.3)

¹¹¹ Referuar “Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit” (Ref. Nr. 6)

¹¹² Referuar “G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik” (Ref. Nr. 41)

¹¹³ Referuar “Plani Strategjik për zhvillimin e programit” (Ref. Nr. 4);

Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”; “2021-2025” (Ref. Nr. 3; 3.3)

shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	kryesorë janë trajnimet e stafit për mësimdhënie dhe kërkim shkencor me qëllim kualifikimin dhe avancimin e qasjes së tij përkundrejt mësimdhënies apo kërkimit shkencor në nivele më të avancuara ¹¹⁴ .			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Trajnimet e stafit për mësimdhënie dhe kërkim shkencor janë zhvilluar nga institucioni me qëllim kualifikimin dhe avancimin e qasjes së stafit akademik përkundrejt mësimdhënies, këshillimit të karrierës, kërkimit shkencor, “Si të jemi lektorë të suksesshëm”, “Si të publikojmë dhe hulumtojmë”, “Rregullat bazë të komunikimit dhe marketingut”, “Çfarë është edukimi”, “Çfarë do të thotë të menaxhosh”, “Zhvillimi i personelit akademik” ¹¹⁵ .			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Për programin e studimit angazhohen personel akademik dhe personeli ndihmës akademik, për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave sa më të reja në mënyrë që përfaqësojnë studentin me të jetë sa më efektive dhe frytshme për të dyja palët ndërvepruese ¹¹⁶ .			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Për sistemin Learning Management System është aplikuar metoda hibride e mësimdhënies. Nëpërmjet sistemit gjenerohen raporte për aktivizimin e studentëve, për rezultatet dhe vazhdimisht bëhen trajnime për stafin akademik. Në fund të çdo viti akademik analizohen raportet e gjeneruara nga LMS dhe shikohen efektet e aplikimit të sistemit ¹¹⁷ .			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Institucioni vazhdimisht fton lektorë të huaj dhe vendas. Në kuadër të ndërkombëtarizimit UET është vizituar nga lektorë të huaj të institucione partnere, të cilët janë angazhuar në mësimdhënie dhe leksione të hapura. Pra, shpalosen qartë përpjekjet e institucionit në angazhimin në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke nxitur ndërveprimin, ku studenti është në qendër të mësimdhënies, ti zhvillohen aftësitë, të menduarit kritik e krijues, dhe që të aftësohet për të punuar në mënyrë të pavarur ¹¹⁸ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹¹⁴ Referuar “Statuti i UET”, Kreu IV, neni 36 (Ref. Nr. 2)

¹¹⁵ Referuar “Referuar “Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës” (Ref. Nr. 39);

Referuar “Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS” (Ref. Nr. 46.1);

Referuar “UET LMS Guide për pedagogun” (Ref. Nr. 46.2)

¹¹⁶ Referuar “Statuti i UET”, Kreu V, neni 43 (Ref. Nr. 2)

¹¹⁷ Referuar “Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS” (Ref. Nr. 46)

¹¹⁸ Referuar “Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit” (Ref. Nr. 43)

Standardi III.5				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga institucioni bëhen publike dhe njihen nga studentët kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm si: provimit përfundimtar, kolokiume, provimit të ndërmjetëm, detyrë kursi, nivelit të diskutimit në seminare apo detyrave praktike ¹¹⁹ .			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga pedagogu sikurse edhe nga institucioni gjatë fillimit të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve ¹²⁰ nga titullari i lëndës/modulit. Ata informohen në sistemet e platformave si UMIS, LMS ¹²¹ apo me anë të postës elektronike në lidhje me format e vlerësimit dhe detyrimeve që duhet të përmbushin lidhur me to. Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) si dhe shprehet me gërma nga F në A, sipas tabelës së mëposhtme. Notat nga 5 (pesë) në 10 (dhjetë) dhe gërmat nga E në A janë kaluese ¹²² .			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Mënyra e vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të tregojë sa më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë procesit të mësimdhënies. Pra, falë kombinimit të disa komponentëve vlerësues është evidentuar edhe nga fokus-grupet se studentët janë mjaft të kënaqur e të lehtësuar nga kjo shpërndarje dhe format vlerësimi, që u vjen në ndihmë maksimalisht për përgatitjen dhe performimin në provim studentëve ¹²³ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹¹⁹ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu V, neni 23, (Ref. Nr. 5)

¹²⁰ Referuar “Syllabuset e lëndëve të ofruara” (Ref. Nr. 19)

¹²¹ Referuar “Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS” (Ref. Nr. 46)

¹²² Referuar “Rregullore e UET”, Kreu V, neni 23 (Ref. Nr. 5);

Referuar “Rregullore e UET”, Kreu V, neni 24 (Ref. Nr. 5)

¹²³ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 5, pika 2 (Ref. Nr .7)

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen brenda afatit të caktuar në Kalendarin e Vitit Akademik. Si rregull, provimet e ndërmjetme zhvillohen në javën e 7-të të semestrit me kohëzgjatje normale, ndërsa provimet përfundimtare në fund të semestrit. Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen brenda afatit të caktuar gjatë gjithë Kalendarit të Vitit Akademik. Shpërndarja e tyre është në: provim përfundimtar, kolokiume, provim të ndërmjetëm, detyrë kursi, nivelit të diskutimit në seminare apo detyrave praktike. Si rregull, provimet e ndërmjetme zhvillohen në javën e 7-të të semestrit me kohëzgjatje normale, ndërsa provimet përfundimtare në fund të semestrit ¹²⁴ .
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Një tjetër masë që institucioni vë në zbatim për të eliminuar forma të ndryshme abuzimi dhe rritur transparencën janë sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat shmangin jo objektivizmin në vlerësim, thjeshtojnë procesin vlerësues dhe rrisin paanshmërinë. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Sekretimi i tezave përmes sistemit të barkodeve ofron sekretim të identitetit të studentit dhe paanshmëri të vlerësimit ¹²⁵ . Një tjetër rast evidentimi i kësaj është aplikimi i projektit Clean Score, i cili realizon korrigjimin e automatizuar të provimeve.
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e diplomës ¹²⁶ me 5-7 vetë dhe praktikës mësimore ¹²⁷ me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. Ndërkohë për lëndët e programit mësimor vlerësimi i dijeve kryhet nga titullari i lëndës.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Realizimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi për mundësimin e këtij objekti. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore ¹²⁸ .
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi	Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Teza shoqërohet me komente/feedback, dhe nëse është e nevojshme, shoqërohet

¹²⁴ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 5, pika 3.1 (Ref. Nr.7)

¹²⁵ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 5, pika 3.2 (Ref. Nr.7)

¹²⁶ Referuar “Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” (Ref. Nr. 10)

¹²⁷ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu VI, neni 34 (Ref. Nr. 5)

¹²⁸ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 5 pika 3.2 (Ref. Nr.7)

<p>procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>gjithashtu dhe me sqarime për vlerësimin e caktuar sikurse edhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen¹²⁹.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Gjatë zhvillimit të provimeve njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën ku kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. Gjatë provimeve angazhohen disa pedagogë për monitorimin e tyre, po ashtu përdoret platforma Turnitin, e cila ofron kontrollin e plagjiaturës duke raportuar imtësisht çdo referencë të mundshme të përdorur të pacituar¹³⁰.</p>			
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale mbështeten mbi meritën, ku pedagogu falë sekretimit të tezave nuk është në dijeni mbi identitetin e studentit dhe jepen në kohën e parashikuar sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre¹³¹.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Brenda dy javëve, pas dorëzimit të vlerësimeve të provimeve në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore¹³².</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Pas zhvillimit të provimit në rast se ndeshet kërkesë apo ankimim, ajo do të shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (kolokium, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një Komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. Procedura e ndjekur pasi i është dhënë zgjidhje respektivisht do të dokumentohet dhe arkivohet¹³³.</p>			
	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>

¹²⁹ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 5 pika 3.3 (Ref. Nr. 7)

¹³⁰ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu V, neni 33 (Ref. Nr. 5)

¹³¹ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 5, pika 3.4 (Ref. Nr. 7)

¹³² Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 5, pika 7.1 (Ref. Nr. 7)

¹³³ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 5, pika 7.2 (Ref. Nr. 7)

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit “Master i Shkencave”, synon ta pajisë studentin me: <ul style="list-style-type: none"> • Njohuri dhe koncepte të avancuara të fushës së studimit; • Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; • Formim qytetar të përgjithshëm; • Aftësi për veprimtari kërkimore shkencore; • Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; • Aftësim për promovim personal;
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Nga monitorimi në cilësinë e GVB vlerësohet që programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, (përfshirë edhe në gjuhë të huaj) në mënyrë që t’i përgatisë studentët me njohuri bazë aplikative në këtë fushë si dhe nëdisiplinat mbështetëse, të formojë specialistë me kompetenca të zgjeruara praktike në fushat e implementimeve të sistemeve informatike si dhe specialistë në lidhje me nevojat e teknologjisë së informacionit në sektorin publik apo privat. Literatura në gjuhë të huaj ¹³⁴ i përgatit studentët tanë për terma ndërkombëtar të teknologjisë. Njëkohësisht njehson njohuritë e marra në këtë program me vendet simotra perëndimore.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, si specialistë në perdorimin dhe administrimin e rrjetave, të mjeteve dhe mënyrave të transportit, përpunimit të zërit, të të dhënave dhe të figurës, për të ofruar aplikime dhe shërbime komunikuese multimediale në kohë reale, transaksione bankare të sigurta, diagnostikime mjekësore në largësi, etj., të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde ¹³⁵ .
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Nga procesi i vlerësimit konkludojmë që ky kriter plotësohet pasi lëndët janë shpërndarë në mënyrë të atillë që njohuritë e fituara në njërin lëndë të implementohen në lëndën tjetër në mënyrë që studenti të ketë performance maksimale. Raste konkrete janë lëndët:”Menaxhim rrjetash kompjuterike” dhe “Menaxhim i riskut në IT” ku njohuritë e marra në lëndën e parë shërbejnë për lëndën tjetër ¹³⁶ .
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në vazhdimësi personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit si orë të klubit të IT apo pjesë të forumeve e workshopeve të ndryshëm, ku

¹³⁴ Referuar “Syllabuset e lëndëve të ofruara” (Ref. Nr. 19)

¹³⁵ Referuar “Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit” (Ref. Nr. 36)

¹³⁶ Referuar “Kurrikula e programit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 14)

	<p>studentët kanë mundësinë e zgjerimit të dijeve dhe prezantimit me risi të reja në fushën ku ata studiojnë. UET ka disa marrëveshje bashkëpunimi me kompani si Infosoft, të cilat bëjnë të mundur angazhimin e personelit të tyre në trajnime të zhvilluara përmes leksioneve të hapura dhe orëve laboratorike¹³⁷.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Prej këtej ata do të mund të marrin njohuri të thella tekniko-praktike të nivelit profesional dhe praktik, që kërkohen nga fusha të ndryshme të teknologjisë së informacionit për teknik të lartë, do të fitojnë aftësi për zgjidhjen e problemeve të teknologjisë së Informacionit dhe për t’u përshtatur me lehtësi me evolucionin e vazhdueshëm të teknologjisë, për të kuptuar dhe analizuar funksionimin e sistemeve relativisht komplekse, për të administruar rrjete të kompleksitetit të ulët dhe të mesëm dhe për të kuptuar parimin e pajisjeve kompjuterike, kabllimin dhe shpërndarjen e internetit dhe shërbimeve të mbështetura në të, etj. si edhe aftësi për t’u specializuar brenda një kohe të shkurtër edhe në mënyrë autonome, mbi bazën e kërkesave të tregut të punës¹³⁸. Sa i takon praktikave profesionale, UET ka akomoduar një numër kërkesash të studentëve për të zhvilluar praktikën në njësi të ndryshme administrative si: Bibliotekë, Zyrën e Kujdesit ndaj Studentëve, Zyrën e Karrierës dhe Praktikave, Zyrën e Aktiviteteve, Zyrën e IT-së, pranë koordinatorëve të Departamenteve. Megjithatë pjesa më e madhe e kërkesave janë akomoduar në institucionet dhe kompanitë të ndryshme bazuar po ashtu edhe mbi marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, dhe për praktikën profesionale¹³⁹.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Personeli akademik është mjaft suportues në rritjen e frymës bashkëpunuese në grup dhe kjo shihet qartë teksa ai mbështet diskutimet dhe punën në grup në detyrat e kursit¹⁴⁰. Gjithashtu pedagogët trajtojnë raste studimore gjatë leksioneve, ku përfshijnë studentët në analizimin dhe zgjidhjen e tyre.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Personeli akademik mision kryesor ka studentin dhe përparimin e tij në studime e mësimnxënie dhe kështu që ai krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. Stafin inkurajon studentët për kërkim shkencor bazuar dhe tek “Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020”, një nga objektivat e të cilit është realizimi i një mjedisi stimulues të kërkimit shkencor për stafin akademik dhe</p>

¹³⁷ Referuar ”Marrëveshja e bashkëpunimit midis UET dhe Infosoft Nr.14.prot datë 23.01.2018” (Ref. Nr. 34.2)

¹³⁸ Referuar “Infrastruktura në funksion të programeve të studimit” (Ref. Nr. 42)

¹³⁹ Referuar ”Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale”; ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 5 (Ref.Nr.32; Ref. Nr. 0.2)

¹⁴⁰ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 5, pika 7.2b (Ref. Nr.7)

	studentët ¹⁴¹ .			
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni UET ka orientim gjithnjë suportues mbi studentët dhe promovon programe e mbështet projekte për zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore duke i mbështetur financiarisht studentët me anë të çmimeve që ofrohen. Nga fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës është realizuar aktiviteti Shkolla Dimërore e Inovacionit/2019 (referuar Shkollat sezonale/Shkurt-Innovation). Po ashtu janë thirrjet për pjesëmarrje në konkurse propozim idesh të organizuara nga UET ¹⁴² .			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	UET ka si politikë institucionale mbështetjen e këshillit të studentëve nga ana logjistike dhe mund të financojë projekte të tyre ¹⁴³ . Gjithashtu evidentohet se një pikë e fortë e institucionit tonë është bashkëpunimi shumë i suksesshëm falë zyrës së projekteve ku mundësohet shkëmbimi i studentëve në nivel ndërkombëtar nëpërmjet programave Erasmus, projekt ky që ka funksionuar shkëlqyer më së miri në gjithë tërësinë e tij ¹⁴⁴ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi dhe/ose kërkimi ose nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP). Institucioni harton procedurë specifike për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike për ta ¹⁴⁵ .
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik i orientojnë mjaft mirë studentët, duke i asistuar nëpërmjet vënies në dispozicion të informacioneve, udhëzimeve dhe materialeve të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. Ata marrin leksionet e hedhura në platformat e miratuara si LMS apo UMIS, u jepet një grup pyetjesh orientuese për secilën kategori lëndësh dhe zhvillohen seanca sqaruese një ditë përmbledhëse ku çdo pedagog informon një nga një mbi lëndën që mbulon çështjet ku studentët duhet të fokusohen më së shumti. Në funksion të udhëheqjes së temave

¹⁴¹ Referuar “Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020”; “2021-2025” (Ref. Nr. 3.1; 3.2)

¹⁴² Referuar “Të dhëna për trajnimet profesionale” (Ref. Nr. 33)

¹⁴³ Referuar “Statuti i UET”, Kreu VII, neni 51, pika 6 (Ref. Nr. 2)

¹⁴⁴ Referuar “Mobiliteti i studentëve Erasmus+” (Ref. Nr. 28.1)

¹⁴⁵ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 8 pika 1 (Ref. Nr. 7); Referuar “Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” (Ref. Nr. 10)

	të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallura ¹⁴⁶ .
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa shlyer të gjitha detyrimet e tjera të programit të studimit. Në rastin e programit “Master i Shkencave”, studentët zhvillojnë temë diplome dhe jo PPP. Procedurat e mbrojtjes së diplomes janë sqaruar në kriterin e mëparshëm.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët qoftë për përgatitjen e provimit final ashtu edhe për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur ¹⁴⁷ . Kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës përcaktohen me rregullore të veçantë. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike ¹⁴⁸ .
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni bën përpjekje përmes programeve të instaluar në sallat laboratorike, për të mundësuar asistencë studentëve sikurse rasti i MYSQL, SQL Server developmnet, IntelliJ, NetBeans; Apache TomCat; SPSS 20, për zhvillimin e programeve aplikative. Pra ata mund të shfrytëzojnë mjediset e institucionit për të ndërtuar ambjentin eksperimental dhe kryer zhvillimin e matjeve respektive ¹⁴⁹ .
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur ¹⁵⁰ . Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike. Udhëheqësi i diplomës ndihmon studentin në analizën empirike të rezultateve, si dhe respektimin e formatit të UET. Ai siguron cilësinë e rezultateve dhe aprovon ose jo punimin kur ai është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë. Kalendari akademik parashikon 4 (katër) sezone për mbrojtjen e diplomës / PPP, të cilat janë: (1) Java e 1-rë e tetorit (2) java e 4-rt e nëntorit (3) java e 1-rë e marsit (4) java e 3-të e korrikut. Studenti që merr notë jokaluese në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. Studenti ka të drejtë të hyjë 2 (dy) herë në mbrojtjen e diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezultojnë mbetës, studentin duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim të ri diplome ¹⁵¹ .

¹⁴⁶ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 8 pika 2 (Ref Nr.7);

Referuar “Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” (Ref. Nr. 10)

¹⁴⁷ Referuar “Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” (Ref. Nr. 10)

¹⁴⁸ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu IX, neni 39 pika 3 (Ref Nr.5)

¹⁴⁹ Referuar “Infrastruktura në funksion të programeve të studimit” (Ref. Nr. 42)

¹⁵⁰ Referuar “Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” (Ref. Nr. 10)

¹⁵¹ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 8, pika 6 (Ref. Nr.7);

Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 8, pika 7 (Ref. Nr.7)

Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përmbyllje të ciklit të dytë të studimit, studenti pajiset me diplomë, suplementin e diplomës dhe certifikatë notash nga institucioni brenda 6 (gjashtë) muajsh, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin ¹⁵² .			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti ka të drejtë të kërkojë të marrë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Institucioni ruan duke magazinuar për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse ato kërkohen ¹⁵³ . Nga depozitimet përkatëse të dokumentacioneve mund të gjendet në çdo moment një kopje respektive duke verifikuar zbatimin e rregullores në çdo pike ¹⁵⁴ .			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit	Nga kryerja e vlerësimit të brendshëm u vërejt që institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Po ashtu evidentohet, që institucioni disponon rregullisht listën e plotë të personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit për secilin

¹⁵² Referuar “Rregullore e UET”, Kreu IX, neni 40 (Ref. Nr.5)

¹⁵³ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu IX, neni 41, pika 3 (Ref. Nr.5)

¹⁵⁴ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu IX, neni 41, pika 3 (Ref. Nr.5)

ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrative. Aty evidentohet angazhimi i çdo anëtari si në çdo semestër ashtu dhe në çdo vit akademik ¹⁵⁵ .
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Në bazë të vlerësimit të kryer nga GVB është evidentuar se institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren, ku komisioni i mbledhur me kompetencë të plotë për përzgjedhje stafi interviston secilin kandidat të interesuar për punësim pasi ka shyrtuar më parë dosjet e plotë të tij dorëzuar paraprakisht burimeve njerëzore; Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë, ku konkretisht do të njehsohej në 83.68%; Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit; Vlerësimi i pedagogut është në qendër të vëmendjes së institucionit. Vlerësimi i pedagogut realizohet me disa mënyra si: <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimit nga përgjegjësi i departamentit; • Vlerësimit nga studentët; • Vlerësimit nga drejtuesit e UET në fund të vitit akademik (procesi follow-up) Zyra e burimeve njerëzore mban dhe ruan një bazë të plotë dhe të qartë të raporteve të rekrutimit të stafit akademik, njoftimeve për punësim etj ¹⁵⁶ .
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Nga vlerësimi rezulton se institucioni harton dhe publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Për çdo vend vakant njoftimet bëhen në faqjen zyrtare të universitetit ¹⁵⁷ , rrjetet sociale ¹⁵⁸ dhe në gazetën Liberale.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	GVB vlerëson se standardet e menaxhimit të burimeve njerëzore, të personelit akademik dhe atij mbështetës përmbushen, jo vetëm në drejtim të zbatimit të procedurave ligjore të rekrutimit, por edhe në drejtim të zhvillimit dhe rritjes profesionale me qëllim përmbushjen e objektivave të programi ¹⁵⁹ . Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm përzgjidhen me konkurs në përputhje me kriteret specifike të kualifikimit dhe performancës të zbatueshme në UET, kandidati i përzgjedhur

¹⁵⁵ Referuar “Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit ndër vite” (Ref. Nr. 24);

Referuar “Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit” (Ref. Nr. 25)

¹⁵⁶ Referuar “Statuti i UET”, Kreu IV, neni 44 pika 1 (Ref. Nr. 2)

¹⁵⁷ Referuar “Faqja zyrtare e Universitetit European të Tiranës www.uet.edu.al” (Ref. Nr. 47)

¹⁵⁸ Referuar “Shembull thirrje për staf akademik” (Ref. Nr. 11.1)

¹⁵⁹ Referuar “Statuti i UET”, Kreu V, neni 44, pika 1 (Ref. Nr. 2);

Referuar “Statuti i UET”, Kreu V, neni 44, pika 2 (Ref. Nr. 2)

	merret fillimisht me kontrate pune 1-vjeçare; kontrata nënshkruhet nga administratori dhe i punësuari, pasi kryhet dhe firmoset një deklaratë vlerësimi akademik nga dekani ose nga rektori në rastin e kontratës së dekanëve. Pas përfundimit të kontratës dhe plotësimit të kushteve të saj, punonjësit me grada shkencore mund të lidhin kontratë pune me afat ose pa afat. Për personelin akademik me kohë të pjesshme kontrata e punës është me afat semestral, me të drejtë rinovimi. Detyrat dhe të drejtat e stafit drejtues, mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ janë përcaktuar në Statutin, rregulloret e institucionit, Kodin e Etikës dhe Kodin e Integritetit akademik, në dokumentet mbështetëse si dhe në kontratat individuale të punës dhe anekseve të kontratave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Një nga detyrat ku institucioni angazhohet është ajo për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Ka një bashkërendim, i cili mundëson që pedagogu të ndjehet komod dhe të aksesojë gjithçka është e nevojshme për veprimtarinë e tij profesionale ¹⁶⁰ .
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. Për këtë gjë zhvillohen trajnime të ndryshme mbi avancimin në profesionalizëm e menaxhim të programit të studimit ¹⁶¹ . Zhvillimi profesional i stafit është një ndër objektivat strategjik të institucionit, i cili garantohet si nga zhvillimi i aktiviteteve nga vetë institucioni ashtu edhe nga mbështetja institucionale për stafin për të ndjekur trajnime dhe aktivitetet të tjera zhvillimore në institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Zhvillimi i konferencës shkencore ‘Ditët e Studimeve Shqiptare’ ¹⁶² , sikurse dhe botimi i revistave shkencore (Revista Economicus e specializuar në fushën e shkencave ekonomike) janë disa nga treguesit e rëndësishëm që institucioni i kushton zhvillimit të vazhdueshëm të stafit. Përfshirja në një numër të konsiderueshëm projektesh, të financuara nga donatorë të ndryshëm, dhe me partnerë nga vendet e BE-së dhe rajoni, është një tjetër tregues i strategjisë së institucionit në kuadër

¹⁶⁰ Referuar “Infrastruktura në funksion të programeve të studimit” (Ref. Nr. 42)

¹⁶¹ Referuar “Statuti i UET” kreu V, neni 44, pika 3 (Ref Nr.2)

¹⁶² Referuar “Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)” (Ref. Nr. 55)

	të zhvillimit të vazhdueshëm të stafit ¹⁶³ . UET ka ndërtuar skemën e financimit të kërkimit shkencor, duke krijuar një fond prej 75.000 Euro për stafin që boton artikuj në revista shkencore të indeksuara në Thomson Reuters. Nisma më e fundit e UET është krijimi i një Grupi Kërkimi Ndërdisciplinor prej 10 profesorësh të disiplinave të ndryshme, të cilëve iu është akorduar një fond vjetor për kërkim shkencor, prej 5.000 euro/secili.			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni ka si qëllim organizimin e programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. Përmes tyre ai kërkon të mbajë stafin në koherencë me përparimet teknologjike e kështu edhe ata do të mund ta transmetojnë këtë tek studentët ¹⁶⁴ .			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Nga monitorimi si GVB vërehet se institucioni ofron mbështetje për kërkimin shkencor, trajnimet e vazhdueshme me qëllim përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë ¹⁶⁵ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Godina B është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m ² . Godina C (biblioteka) gjithsej 300 m ² . Për programin e studimit “Master i Shkencave” janë në dispozicion 4 Laboratorë Informatike, përkatësisht: <ul style="list-style-type: none"> - Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor rreth 45 m²; - Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m²; - Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45

¹⁶³ Referuar “Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit” (Ref. Nr. 43)

¹⁶⁴ Referuar “Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës” (Ref. Nr. 39);

Referuar “Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS” (Ref. Nr. 46.1);

Referuar “UET LMS Guide për pedagogun” (Ref. Nr. 46.2)

¹⁶⁵ Referuar “Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional” (Ref. Nr. 38)

	<p>m2;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lab 208 B me 80 PC (laboratori i internetit) – 160m2. <p>Të gjitha sallat në të cilat zhvillohen si leksionet ashtu edhe seminarat janë të pajisura me PC dhe videoprojektor, të cilat i vijnë në ndihmë si studentëve ashtu edhe stafit akademik¹⁶⁶.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>UET ka në përdorim laboratorë mësimorë informatike, të cilat janë të pajisura me PC, video projektor dhe mjete të tjera audio vizive, të cilat janë përshtatshme në raport me numrin e përgjithshëm të studentëve që i përdorin ato sikurse dhe janë të përshtatshme dhe në përputhje me qëllimet e programit. Të gjitha sallat në të cilat zhvillohen si leksionet ashtu edhe seminarat janë të pajisura me PC dhe videoprojektor, të cilat i vijnë në ndihmë si studentëve ashtu edhe stafit akademik. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal Wi-Fi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë webin. Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit. Laboratorët e informatikë/statistikës janë pajisur me software-ët e nevojshëm për zhvillimin e praktikave profesionale. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit IV.3.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin mjaft modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit, instalimet e programeve dhe përditësimet e tyre bëhen në kohë reale. Në të njëjtën kohë në kompjutera janë instaluar programet aplikative që kërkohen nga secila lëndë e programit. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit IV.3.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni, në godinën B, strehon laboratorët si më poshtë vijon për Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Laboratori i integruar i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës me sipërfaqe rreth 130 m2, i cili është në fazën e finalizimit dhe pajisjes me kapacitetet përkatëse didaktike. - 4 Laboratorë Informatike, përkatësisht: <ul style="list-style-type: none"> - Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor rreth 45 m2; - Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m2; - Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m2; - Lab 208 B me 80 PC (laboratori i internetit) – 160m2. <p>Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit IV.3.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe</p>	<p>Sa i takon praktikave profesionale, UET ka akomoduar një numër kërkesash të studentëve për të zhvilluar praktikën në njësi të ndryshme administrative si: Bibliotekë, Librari, Zyrën e Kujdesit ndaj Studentëve, Zyrën e Karrierës dhe Praktikave,</p>

¹⁶⁶ Referuar “Infrastruktura në funksion të programeve të studimit” (Ref. Nr. 42)

të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Zyrën e Aktiviteteve, Zyrën e IT-së, pranë koordinatoreve të Departamenteve. Megjithatë pjesa më e madhe e kërkesave janë akomoduar në institucionet dhe kompanitë të ndryshme. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit IV.3.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e UET është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Për realizimin e programeve biblioteka zotëron gjithsej 6005 tituj të disponueshëm për studentët, nga këto në shqip janë 4634 tituj dhe në gjuhë të huaj 1371 ¹⁶⁷ .
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Për programet e studimit “Master i Shkencave”, në bibliotekë gjenden shumë tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse bashkëkohore dhe në pjesën më të madhe të shkruar nga autorë të huaj të njohur ndërkombëtarisht në shkollat më të dëgjura. Biblioteka e UET furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: Questia, Social Science Library, Sage. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS.Net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit IV.4.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Institucioni mbështet gjetjen e burimeve on-line të kërkuara nga pedagogët dhe studentët. Botimet periodike në total janë 162, nga këto 102 janë në shqip dhe 60 janë në gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht). Ai ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit ¹⁶⁸ .
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë	Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me pc në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UET. Ajo është e pajisur me programe

¹⁶⁷ Referuar “Infrastruktura në funksion të programeve të studimit” (Ref. Nr. 42)

¹⁶⁸ Referuar “Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit MSh Teknologji Informacioni” (Ref. Nr. 45)

shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve ¹⁶⁹ .			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	UET bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer pedagogëve dhe studentëve. Sikurse vërehet nga ky dokument, lista e teksteve e librave shtohet vit pas viti duke pasuruar fondin e aksesimit të informacionit për të gjitha palët e interesuara. Referenca është e njëjtë me kriterin 3 të standartit IV.4.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hëne-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00:17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve është me orar të zgjatur. Këto orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Referenca është e njëjtë me kriterin 4 të standartit IV.4.			
Shkalla e përmbushjes së standartit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UET disponon sistem të menaxhimit me anë të të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit “Master i Shkencave”. Ai e ruan këtë databazë si një indikator masivisht të rëndësishëm vendimarrjeje në lidhje me aspektet më kritike duke konsideruar këto të dhëna si pikë e fortë reference ¹⁷⁰ .
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i brendshëm i menaxhimit është pikërisht aktori kryesor në institucionin e Universitetit European të Tiranës që administron informacionin e ruajtur, dokumentacionin dhe aktivitetin e disponuar të personelit akademik, sikurse edhe të personelit ndihmës akademik, apo personelit administrativ dhe partnerëve të përfshirë në realizimin e programit të studimit “Master i Shkencave” ¹⁷¹ .
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit që administron informacionin e ruajtur, dokumentacionin dhe aktivitetin e disponuar të personelit akademik, sikurse edhe të personelit ndihmës akademik, apo personelit administrativ dhe partnerëve të përfshirë në

¹⁶⁹ Referuar “Infrastruktura në funksion të programeve të studimit” (Ref. Nr. 42)

¹⁷⁰ Referuar “Statuti i UET”, Kreu V, neni 53, pika 1 (Ref. Nr. 2)

¹⁷¹ Referuar “Statuti i UET”, Kreu V, neni 53, pika 2 (Ref. Nr. 2)

	realizimin e programit “Master i Shkencave” siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit ¹⁷² .			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Mbi rekomandimin e implementimit të një sistemi të qëndëruar për automatizimin e menaxhimit të studentëve dhe personelit, institucioni ka ofruar dy sisteme të automatizuara sikurse janë LMS dhe UMIS ¹⁷³ , të cilat u vijnë në ndihmë si pedagogëve ashtu edhe studentëve; të shkëmbejnë informacion të shpejtë, të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme duke i menaxhuar nga zyra, shtëpia apo telefoni aplikacionet në fjalë nga të dyja palët e interesuara ku pedagogu hedh detyra, leksione, libra, linqe, pyetësorë apo shpall njoftime dhe nga ana tjetër studenti i merr njoftimet, shkarkon leksionet, librat, njoftohet mbi notat, pikët e përfutuara nga seminarët, detyrat e kursit, esetë, etj. Sistemi i menaxhimit me platformat e integruara LMS ose UMIS që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve paraqet një zgjidhje të shkëlqyer dhe shumëvlerësuar si një pikë të fortë e universitetit tonë të cituar në 100% të rasteve të studentëve të anketuar.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët përmes platformave LMS dhe UMIS. Sekretaria mësimore në kohë reale gjeneron raporte individuale për secilën lëndë në përputhje me kërkesat ¹⁷⁴ .			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Për rekomandimin e pasurimit të faqes së internetit me të dhëna mbi procesin dhe rezultatet e akreditimit të institucionit dhe programeve mësimore, institucioni ka avancuar duke e realizuar këtë rekomandim dhe ku mund të shihen qartë në faqen e internetit të reflektuara dokumenta mbi akreditimin institucional dhe programeve respektive përkatëse. Informacionet që lidhen me programet e studimit janë transparente e lehtësisht të aksesueshme përsa i përket, personelit akademik, aktiviteteve të ndryshme, etj të cilat publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. Kjo ka qenë dhe një ndër kriteret e plotësuar të rekomandimeve ku institucioni ka ndërmarrë ¹⁷⁵ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁷² Referuar “Statuti i UET”, Kreu VII, neni 53, pika 3 (Ref. Nr. 2)

¹⁷³ Referuar “Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS” (Ref. Nr. 46)

¹⁷⁴ Referuar “Statuti i UET”, Kreu VII, neni 53, pika 5 (Ref. Nr. 2)

¹⁷⁵ Referuar “Faqja zyrtare e Universitetit European të Tiranës www.uet.edu.al” (Ref. Nr. 47)

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Për secilin vit akademik, institucioni harton raportin në lidhje me koston për programet e studimit për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve. Për nevojat e drejtimit ai mban të dhëna krahasuese edhe për vitet e kaluara duke bërë të mundur evidentimin e elementeve kryesore që ndikojnë në performancën e kompanisë, për të dhënë qendrueshmëri dhe rezultat¹⁷⁶. Buxheti financiar hartohet në muajin tetor të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri Z. Henri Çili. Për zbatim të këtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku percaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Për çdo veprim blerje dhe shitje zyra e financës pajiset me “Kërkesë për Lëvrim fondesh”, e miratuar nga Administratori. Veprimet e shoqërisë kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar duke siguruar transparencë të plotë. Institucioni dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare plotëson standardet e kërkuara. UET respekton standardin e hartimit të raportimit financiar dhe të evidentimit të kostos së studimit. Pasqyrat financiare përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Plani i financimit të programit të studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij¹⁷⁷.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin</p>	<p>Institucioni kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit¹⁷⁸. EEI shpk përgjatë vitit 2016-2017 ka marrë konsulencë financiare nga shoqëria “Deloitte Albania”. E.E.I. shpk</p>

¹⁷⁶ Referuar “Të dhëna mbi koston për student”; ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 18.1 (Ref. Nr. 49; Ref. Nr. 0.2)

¹⁷⁷ Referuar “Të ardhura dhe financime të ndryshme”; ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabelat 18.2 (Ref. Nr. 50; Ref. Nr. 0.2)

¹⁷⁸ Referuar “Statuti i UET”, Kreu VIII, neni 54, pika 5 (Ref. Nr. 2); Referuar “Statuti i UET”, Kreu VIII, neni 54, pika 6 (Ref. Nr. 2)

<p>financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>përmbush kushtet për kryerjen e një ekspertize, prandaj çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Burim kryesor financimi janë tarifat për dhe gjatë shkollimit, ndërsa një kontribut tjetër lidhet me aktivitetet tregtare (qeradhenie, parkim etj.) Specifike për vitet e fundit 2013-2018 është edhe kontributi i granteve për kërkim, siguruar nga projekte të ndryshme me donatorë të huaj, ku U.E.T. është pjesëmarrës. OPINIONI: Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. UET pas mbylljes e pasqyrave financiare kryen auditimin e jashtëm nga audituesi ligjor. Raporti i auditimit merr për bazë të gjitha informacionet dhe materialet e nevojshme në lidhje me situatën dhe performancën financiare të shoqërisë. Raporti i auditimit përmban analizën e zërave të pasqyrave financiare, si edhe opinionin në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit¹⁷⁹. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
-----------------------------------------------------------------	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------

¹⁷⁹ Referuar “Të ardhura dhe financime të ndryshme”; ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabela 18.2 (Ref. Nr. 50; Ref. Nr. 18.2)

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni publikon kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimit në faqen zyrtare web ¹⁸⁰ në përputhje me politikat institucionale ¹⁸¹ . Institucioni nuk ka kriteret e tjera shtesë, por vetëm ato të parashikuara në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në rastin e programit të studimit “Master i Shkencave” kriteri hyrës është gjuha e huaj. Pra rezulton se institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.
Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni garanton barazi për të gjithë kandidatët për studentë të interesuar. Pra, kriteret e vendosura nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit “Teknologji Informacioni” ¹⁸² .
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Studentët mund të gjejnë të gjithë informacionin rreth programit të studimit “Master i Shkencave”, kriteret e pranimit, bursave që ofrohen tek faqja zyrtare web ¹⁸³ . Gjithashtu informacioni i plotë rreth kriteret, procedurave të pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga vetë studentët ¹⁸⁴ .
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	UET shpall publikisht, kuotat dhe kriteret e pranimit, programet e hapura dhe ato të akredituara të studimeve, para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve ¹⁸⁵ . Njëkohësisht në faqen e internetit institucioni publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. Gjuha e huaj është kriteri hyrës në programet e ciklit të dytë.

¹⁸⁰ Referuar “Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës www.uet.edu.al” (Ref. Nr. 47)

¹⁸¹ Referuar “Statuti i UET”, Kreu IV, neni 32 (Ref. Nr. 2)

¹⁸² Referuar “Rregullore e UET”, Kreu III, neni 11 (Ref. Nr. 5);
Referuar “Rregullore e UET”, Kreu IX, neni 38 (Ref. Nr. 5)

¹⁸³ Referuar “Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës www.uet.edu.al” (Ref. Nr. 47)

¹⁸⁴ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu III, neni 11 (Ref. Nr. 5);
Referuar “Rregullore e UET”, Kreu IX, neni 38 (Ref. Nr. 5);
Referuar “Rregullore e UET”, Kreu VII, neni 35 (Ref. Nr. 5)

¹⁸⁵ Referuar “Statuti i UET”, Kreu IV, neni 30, pika 6 (Ref. Nr. 2)

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Studentët e ardhshëm informohen për programet e studimit dhe kriteret përkatëse për çdo program studimi në faqen zyrtare Web. Referenca është e njëjtë me kriterin 3 të standartit V.1.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni vë në dispozicion gjithë informacionin e duhur në lidhje me kriteret përkatëse e procedurat respektive të përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin sipas rregullores së institucionit ¹⁸⁶ . Njëkohësisht studentët mund të përdorin sistemet UMIS dhe LMS ¹⁸⁷ për tu informuar rreth rezultateve akademike dhe krediteve të fituara.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. UET-i, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera. Procedura e transferimit, nga bërja e kërkesës me shkrim nga studenti, deri në njohjen e lëndëve dhe regjistrimin e tij në këtë program studimi ¹⁸⁸ .
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në rregulloren e programit të studimit ¹⁸⁹ shprehet qartë mënyra e vlerësimit të dijeve në lëndët përkatëse në përputhje me tipologjinë e tyre. Njëkohësisht studenti e merr këtë informacion edhe nga syllabusi i lëndës ¹⁹⁰ . Pra si konkluzion mund të parashtrijmë se institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në fillim të vitit akademik studentët plotësojnë formularin për punimin e diplomës dhe pranë koordinatores së departmentit përkatës marrin informacionin e duhur mbi punimin e temës së diplomës. Gjithashtu koordinatores ju dërgon email për

¹⁸⁶ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu V, neni 29, pika 1 (Ref. Nr. 5);

Referuar “Rregullore e UET”, Kreu V, neni 29, pika 2 (Ref. Nr. 5)

¹⁸⁷ Referuar “Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS” (Ref. Nr. 46)

¹⁸⁸ Referuar “Dokumenti D. II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin” (Ref. Nr. 28)

¹⁸⁹ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu V, neni 24, pika 1 (Ref. Nr. 5);

Referuar “Rregullore e UET”, Kreu V, neni 24, pika 2 (Ref. Nr. 5)

¹⁹⁰ Referuar “Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite” (Ref. Nr.19)

	punimin e diplomes dhe formatin e miratuar nga institucioni ¹⁹¹ .			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni informon vazhdimisht të interesuarit mbi programin e studimit ¹⁹² . Kështu ai zhvillon Ditët e Hapura për cdo Fakultet ku studentë të ardhshëm mund të marrin pjesë e të njihen nga afër me ambientet, profesorët dhe mësimdhënien.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët informohen në mënyrë të detajuar për të gjitha të dhënat rreth programit të studimit duke përfshirë strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve ¹⁹³ . Po ashtu informacioni shfletohet edhe përmes broshurës sqaruese të UET. Gjithashtu edhe Zyra e Kujdesit të Studentëve ¹⁹⁴ i informon studentët rreth programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese nëpërmjet mënyrave të sqaruara më sipër.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga analiza e tregut të punës ¹⁹⁵ evidentohet që institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. Po ashtu nga Zyra e Këshillimit dhe Karrierës ¹⁹⁶ vërehet angazhimi periodik mbi informimin e studentëve mbi mundësitë potenciale të punësimit.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga momenti i regjistrimit e deri në përfundim të studimeve, studentëve i vihet në dispozicion informacioni i nevojshëm mbi organizimin e procesit mësimor. Një nga detyrat e koordinatorës së departamentit është mbajtja e kontakteve të rregullta, njoftimeve elektronike dhe me telefon, me studentët që ndjekin programe studimi të Departamentit. Çdo ndryshim

¹⁹¹ Referuar “Dokumentimi B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” (Ref. Nr. 10)

¹⁹² Referuar “Rregullore e UET”, Kreu VIII, neni 36 (Ref. Nr. 5);
Referuar “Rregullore e UET”, Kreu VIII, neni 37 (Ref. Nr. 5);
Referuar “Komunikimi i integruar i marketingut” (Ref. Nr. 51)

¹⁹³ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu VIII, neni 36, pika 1 (Ref. Nr. 5)

¹⁹⁴ Referuar “Dokumentimi E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit” (Ref. Nr. 12)

¹⁹⁵ Referuar “Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve” (Ref. Nr. 17)

¹⁹⁶ Referuar “Dokumentimi E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit” (Ref. Nr. 12)

	në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve përmes njoftimeve të koordinatoreve të departamenteve dhe shpallet në këndin e njoftimeve. Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UET, dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit LMS ¹⁹⁷ .			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Një tjetër aspekt si funksion i mësimdhënies, të cilin personeli akademik e shfrytëzon për shpërndarjen e informacionit dhe tejçimin e dijeve tek studentët në mënyrë sa më efektive është edhe përdorimi i platformës online (e-learning) dhe mbështetja apo edhe nxitja e personelit akademik e studentëve po ashtu për përdorimin e tyre. Për këtë përdoren platformat LMS dhe UMIS ¹⁹⁸ . Vlen të theksohet se sistemi LMS mund të aksesohet në distancë, sakaq sistemi UMIS brenda ambjentëve të UET.			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	LMS menaxhon aktivitetin mësimor të studentit, komunikimin studentë-pedagog, ndërkohë për dokumentacionin përdoret UMIS, i cili aksesohet nga studentët dhe administrata. Sipas kërkesave specifike nga të dy sistemet në kohë reale gjenerohen raporte.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Në institucionin tonë ruhen statistika të vazhdueshme vjetore mbi numrin e të diplomuarve, në ciklin e dytë për programet tona të studimit dhe konkretisht për programin në fjalë ¹⁹⁹ .
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Universiteti European i Tiranës në databazën e tij të të dhënave ruan informacion edhe mbi numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë. Po ashtu aty gjenden të dhëna edhe mbi tërheqjet e studentëve nga programi i studimit, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve në fjalë. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit V.5.

¹⁹⁷ Referuar “Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS” (Ref. Nr. 46)

¹⁹⁸ Referuar “Statuti i UET”, Kreu VII, neni 53, pika 5 (Ref. Nr. 2)

¹⁹⁹ Referuar “Cilësia në hyrje dhe dalje për programin” (Ref. Nr. 27)

Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Institucioni ka dosje për secilin studentë që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna gjenden në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve ²⁰⁰ .			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nëse kërkohet aksesim dhe verifikim nga personat e autorizuar përkatës mbi të dhënat statistikore të studentëve ai realizohet përmes sistemit të brendshëm të informacionit menaxhimi, i cili ofron siguri, garanci e efikasitet në përdorim. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Përmbajtja e informacioneve/njoftimeve që lidhen me UMIS administrohen nga personi pranë Zyrës IT-së me detyrë funksionale menaxhimin teknik të sistemit UMIS. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit V.5.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Institucioni ynë vazhdimisht përmes zyrës përgjegjëse harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve ²⁰¹ , si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre ²⁰² , duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve si indikatorë reflektues mbi mbarëvajtjen e programit në tërësi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Fjala e studentëve është një zë i fuqishëm pranë institucionit tonë. Studentët përfaqësohen nga të përzgjedhurit e tyre në qeverinë studentore të cilat janë edhe ura lidhëse mes vetë studentëve dhe organet vendimmarrëse. Njëkohësisht ata organizohen në këshillat e studentëve, ku mund të shprehin mendimet e tyre për tematika të ndryshme por me rëndësi për UET ²⁰³ . Ndër strukturat kryesore përmendim: <ul style="list-style-type: none"> • Këshilli i Studentëve - realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese. • Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve.

²⁰⁰ Referuar “Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore” (Ref. Nr. 9)

²⁰¹ Referuar “Cilësia në hyrje dhe dalje për programin” (Ref. Nr. 27)

²⁰² Referuar “Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve” (Ref. Nr. 29)

²⁰³ Referuar “Statuti i UET, Kreu VII, neni 51 (Ref. Nr. 2)

	<ul style="list-style-type: none"> • Këshilli Etikës - një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve. • KSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. • Mbledhjet e departamenteve, një në muaj është e hapur për studentët 								
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Institucioni përmes qeverisë studentore, këshillave studentorë, klubeve, anketimeve të ndryshme përfshin studentët dhe/ose përfaqësuesit e tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. Përfshirja e studentëve garantohet si në mënyrë të drejtpërdrejtë (përfaqësimi në strukturat e analizuara në Kriterin 1) ashtu edhe në mënyrë periodike, nëpërmjet zhvillimit të fokus grupeve, pyetësorëve online dhe kërkesave të studentëve. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm.								
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.	Ngarkesa normale është 60 kredite në vit. Studenti ka të drejtë të marrë më shumë kredite se kjo ngarkesë. Këto kredite i zbriten nga ngarkesa e viteve pasardhëse ²⁰⁴ . Institucioni ka në fokus studentin në rastin e hartimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Llogaritja e ngarkesës bëhet me kujdes në mënyrë që mos të mbingarkohet studenti, por që të marri gjatë viteve të studimit afërshisht të njëjtën ngarkesë.								
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Institucioni duke u mbështetur në vlerësime konkrete sikurse takimet e zhvilluara me anëtarët e tregut të punës dhe studimit të tregut apo edhe nga sondazhet e mbajtura me studentë të mëparshëm Alumni, fokus grupet etj. garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të pasqyron rekomandimet e kontributin e tyre në to ²⁰⁵ .								
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	Studentëve u mundësohet të shprehen lirshëm në fokus grup apo grupe vlerësimi duke dhënë mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës ²⁰⁶ .								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

²⁰⁴ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu IV, neni 13, pika 3 (Ref. Nr. 5)

²⁰⁵ Referuar “Statuti i UET”, Kreu VII, neni 51, pika 5 (Ref. Nr. 2)

²⁰⁶ Referuar “Rregullore e UET”, Kreu IV, neni 22, pika 2b (Ref. Nr. 5)

Standardi V.6				
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Stafi akademik i këtij institucioni merr pjesë në veprimtari kërkimore shkencore ²⁰⁷ . Institucioni në mënyrë të vazhdueshme motivon stafin për t'u angazhuar në kërkime shkencore dhe për t'i paraqitur gjetjet e tyre në konferenca shkencore. Gjithashtu UET organizon konferencën e përvitshme shkencore “Ditët e Studimeve Shqiptare ²⁰⁸ ”.			
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	Institucioni ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione të huaja për programe të përbashkëta studimi, projekte e hulumtime shkencore ²⁰⁹ .			
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	Personeli akademik i orienton studentët e shkëlqyer drejt pjesëmarrjes në kërkim shkencore ²¹⁰ . Gjithashtu në konferencë e përvitshme shkencore të institucionit “Ditët e Studimeve Shqiptare” studentët e ciklit të dytë të studimeve mund të marrin pjesë vetem ose në bashkëpunim me anëtarët e stafit akademik.			
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Institucioni vazhdimisht gjen mënyra për ta stimuluar personelin akademik dhe studentët për të publikuar në revista shkencore me faktor impakti. Institucioni ka miratuar një grant individual për Kërkuesin Shkencor ²¹¹ , për të mbështetur realizimin e punime kërkimore shkencore.			
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Institucioni synon të motivojë studentin për zhvillimin e studimeve inovative nëpërmjet inkubatorëve të biznesit. Personeli akademik mentoron punimet e studentëve. Një rast konkret është konferenca “Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)” ²¹² .			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Punimi i diplomës mund të ketë karakter teorik ose empirik dhe në funksion të temave të zgjedhura zhvillohen seancat metodologjike. Gjatë zhvillimit të seancave metodologjike udhëheqësi ofron ndihmën e nevojshme për zhvillimin e analizës empirike ²¹³ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²⁰⁷ Referuar “Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit” (Ref. Nr. 43)

²⁰⁸ Referuar “Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)” (Ref. Nr. 55)

²⁰⁹ Referuar “Plani Strategjik për zhvillimin e programit” (Ref. Nr. 4);
Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”; “2021-2025” (Ref. Nr. 3; 3.3)

²¹⁰ Referuar “Formati i Syllabusit Cikli i parë dhe dytë” (Ref. Nr. 19.1)

²¹¹ Referuar “Plani Strategjik 2015-2020”; “2021-2025”, prioriteti nr. VI (Ref. Nr. 3; 3.3);
Referuar “Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit” (Ref. Nr. 43)

²¹² Referuar “Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)” (Ref. Nr. 55)

²¹³ Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 8, pika 1 (Ref. Nr. 7);
Referuar “Rregullore mësimore e programit MSh Teknologji Informacioni”, neni 8, pika 3 (Ref. Nr. 7)

Standardi V.7				
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.				
Kriteret		Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.		Institucioni synon ndërkombëtarizimin ²¹⁴ . Një pikë e fortë e institucionit tonë është bashkëpunimi shumë i suksesshëm falë zyrës së projekteve ku mundësohet shkëmbimi i studentëve në nivel ndërkombëtar nëpërmjet programave Erasmus, projekt ky që ka funksionuar shkëlqyer e më së miri në gjithë tërësinë e tij.		
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.		Studentët aftësohen për zhvillimin e hulumtimeve shkencore. Kjo falë lëndës “Metodave të Avancuara Kërkimi” ²¹⁵ , ku ata marrin të gjithë njohuritë e duhura për përgatitjen e punimeve shkencore. Kjo lëndë i ndihmon për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore shkencore për ciklin e tretë të studimit.		
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.		Ky kriter plotësohet duke analizuar përfshirjen e studiuesve të rinj në projektet kërkimore vendase dhe të huaj, ku institucioni është angazhuar.		
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.		Institucioni ka nderuar një sërë kërkuesish shkencore të huaj me tituj dhe ka mundësuar zhvillimin e leksioneve të hapura nga këta hulumtues. Gjithashtu Institucioni synon që konferenca e përvitshme shkencore e institucionit “Ditët e Studimeve Shqiptare” të këtë pjesëmarrje ndërkombëtare. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit V.7.		
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.		Institucioni favorizon mobilitetin e studentëve dhe lehtëson një sërë procedurash në këtë proces me mbështjen e pakushtëzuar të zyrës së projekteve ndaj studentëve. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit V.7.		
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore		Rezulton se marrëveshjet e bashkëpunimit për mobilitetin e stafit akademik kanë bërë të mundur që një sërë profesorësh nga institucione partnere ndërkombëtare të angazhohen në veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie në këtë institucion. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit V.7.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
				X

Standardi V.8				
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.				
Kriteret		Vlerësimi		
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në		Institucioni ynë ndjek një politikë të kënaqshme të mirëpritjes së studentëve të rinj. Njësia e posaçme në shërbim të informimit e		

²¹⁴ Referuar “Mobiliteti i studentëve Erasmus+” (Ref. Nr. 28.1)

²¹⁵ Referuar “Syllabuset e lëndëve të ofruara” (Ref. Nr. 19)

<p>përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>shërbimit të studentëve në UET është zyra e Kujdesit ndaj Studentit²¹⁶. Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Tutoriati dhe këshillimi akademik, sikurse dhe këshilluesit e karrierës në çdo Departament janë gjithashtu në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve²¹⁷.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Falë punës së përhershme të zyrës për këshillimin e karrierës, institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale. Tutoriati është një shërbim akademik që ka si objektiv orientimin e studentëve mbi çdo paqartësi lidhur me procesin mësimor. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit V.8.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni është mjaft i përkushtuar përsa i përket përkujdesjes ndaj studentëve ku ai i dedikon angazhim të veçantë nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës me anë të cilës u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor. Po ashtu institucioni angazhon personelin e tij akademik në shpërndarjen e informacionit mbi prezantimin e fakulteteve respektive, programeve e drejtimeve përkatëse me anë të të cilave studentët e mundshëm të marrin informacionin e duhur për të qënë të qartë në përzgjedhjen e programit të studimit në të cilin do të regjistrohen. Referenca është e njëjtë me kriterin 1 të standartit V.8.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës dhe mbahen kontakte të gjata edhe përtej përfundimit të studimeve pranë fakultetit tonë duke ruajtur kështu marrëdhënie afatgjata me ta, informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi, ku për çdo ofertë për punësim adresuar institucionit tonë u adresohemi studentëve për t'u ardhur në ndihmë e punësuar. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve²¹⁸ të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

²¹⁶ Referuar “Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit” (Ref. Nr. 12)

²¹⁷ Referuar “Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës” (Ref. Nr. 39);
Referuar “Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS” (Ref. Nr. 46.1);
Referuar “UET LMS Guide për pedagogun” (Ref. Nr. 46.2)

²¹⁸ Referuar “Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve” (Ref. Nr. 29)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UET i kushton vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë, për të garantuar që veprimtaria e tij jo vetëm është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore, por gjithashtu që objektivat strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit vazhdojnë të qëndrojnë në themel dhe të drejtojnë punën e përditshme të strukturave drejtuese dhe personelit. ²¹⁹ Kujdes i kushtohet zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fushën e arsimit, me fokusim të veçantë në standardet e cilësisë për të gjitha nivelet. ²²⁰
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë funksionon nëpërmjet këtyre strukturave: Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), i cili e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve <i>ad hoc</i> , dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit ²²¹ . Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore të UET-it. Ai ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Ngritja e organeve Këshilluese si Bordet e Tregut të Punës, sikurse dhe angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm, i përgjigjet gjithashtu nevojës së Universitetit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm në drejtim të ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë.

²¹⁹ Statuti UET, Neni 11&16 (Ref. Nr. 2); Rregullore UET, Neni 6 (Ref. Nr. 5); Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)

²²⁰ Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH", Neni 103 (Ref. Nr. 53); VKM Nr. 531, date 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë" (Ref. Nr. 53.2)

²²¹ Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC_Tabela 24 Aneks (Ref. Nr. 30); Urdhër mbi përbërjen e KSBC (Ref. Nr. 30.4)

	<p>Strukturë tjetër e rëndësishme në sigurimin e brendshëm të cilësisë është dhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC), roli i së cilës është të zhvillojë politikën, strategjitë, proceset dhe udhëzimet, në funksion të rritjes së cilësisë në UET, si dhe të monitorojë zbatueshmërinë korrekte ndaj tyre nga njësitë akademike dhe administrative.²²²</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, monitorimit nga ana e strukturave drejtuese, ZCS, KSBC-së, tërheqjes së mendimit të studentëve, të anëtarëve të Bordeve të Tregut të Punës si dhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore.</p> <p>Universiteti European i Tiranës i është nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme, të lidhura me akreditimin e parë dhe akreditimin periodik Institucional, me vlerësim përfundimtar pozitiv dhe me një kohëzgjatje prej 5 vite akademike²²³.</p> <p>Po ashtu, në kuadër të promovimit dhe përmirësimit të cilësisë, i janë nënshtruar procesit të akreditimit në mënyrë periodike dhe programet e studimit²²⁴.</p> <p>Në këtë drejtim, në UET është zbatuar procesi i kontrollit të ligjshmërisë i ushtruar nga MASR në vitin 2014, sipas së cilit UET plotëson standardet dhe kriteret ligjore për ushtrimin e aktivitetit akademik; janë zhvilluar vizita monitoruese të MASR mbi përmbushjen e kapaciteteve akademike dhe infrastrukurore në funksion të miratimit të kuotave për çdo vit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Veprimtaria e KSBC mbështetet në dokumentet e saj strategjike²²⁵, dhe zhvillohet e organizuar sipas një plani kalendar (Plani i veprimit)²²⁶ të përvitshëm, në të cilin programohen sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet dhe gjetjet përkatëse. Në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e njëjve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së institucionit, njëjve të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p>

²²² Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.5 (Ref. Nr. 8)

²²³ Licencime dhe akreditime: VBA Nr. 12, datë 07.04.2017 "Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë UET"; VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 "Për akreditimin e Universitetit European të Tiranës"; Certifikatë akreditimi UET (Ref. Nr. 54)

²²⁴ Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga departamenti_Tabela 3 Aneks (Ref. Nr. 26)

²²⁵ Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 (Ref. Nr. 30.3)

²²⁶ Plani veprimit KSBC (Ref. Nr. 30.1)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	KSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit. Në funksion të garantimit të cilësisë, rol të rëndësishëm kanë departamentet si njësi përgjegjëse për programin e studimit, ku përgjegjësit e grup-lëndëve/koordinatorët ²²⁷ e programeve kanë detyra specifike që lidhen me çështjet e rishikimit të kurrikulës, silabuseve dhe literaturës në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe standardet dhe Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë së UET. ²²⁸ Bordet e Tregut të Punës kanë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm pasi reflektojnë dinamikat dhe kërkesat që vijnë nga tregu. Këto rekomandime bëhen bazë për ndryshime në kurrikula në funksion të përshatjes sa më mire me këto kërkesa. ²²⁹
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar ²³⁰ . Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel Rektorati, sikurse dhe në nivel departamenti.
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	UET përdor metodologji dhe instrumente vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike. Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues që organizohen nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), për secilin nga proceset akademike që monitorohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve ²³¹ .

²²⁷ Vendimi për emërimin e Koordinatorëve të programeve të studimit (Ref. Nr. 36)

²²⁸ Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 (Ref. Nr. 30.3)

²²⁹ Dokumenti E.VIII. Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave, Pika E.VII.4.1 (Ref. Nr. 13)

²³⁰ Metodologjia e punës së KSBC_Provimet (Ref. Nr. 30.5); Format Raporti_Provimet (Ref. Nr. 30.6)

²³¹ Shpërndarja e relacionit të KSBC për monitorimin e silabuseve (Ref. Nr. 30.7)

	KSBC njëherazi, rekomandon detyra, zbatimi it ë cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe nga vet Komisioni.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Ky kriter plotësohet pasi rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse sikurse dhe titullarit të lëndës, përgjegjësve të grup-lëndëve, përgjegjësit të departamentit, etj. ²³²			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë ²³³ . KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë, monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi nga KSBC bëhet në nivel institucional dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme, secili nga Departamentet përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programet specifike. Këto vlerësime janë pjesë e vetëvlerësimeve në kuadër të akreditimit institucional dhe programeve të studimit.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Institucioni për kryerjen e vlerësimit përdor metoda të tërthorta, të drejtpërdrejta si dhe instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Disa prej metodave që UET përdor për kryerjen e vlerësimeve përfshijnë monitorimin e elementëve të lidhur me proceset akademike si provimet, silabuset, literatura e përdorur, etj. ²³⁴ . Një vend të veçantë zë dhe përfshirja e studentëve në këto procese. Në strukturën e KSBC është një përfaqësues i

²³² Format i relacionit për monitorimin e silabuseve (Ref. Nr. 37)

²³³ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.3-7 (Ref. Nr. 8)

²³⁴ Plani veprimi KSBC (Ref. Nr. 30.1)

	<p>Këshillit të Studentëve²³⁵. Instrumentet kryesor që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UET në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teste të standardizuara; - Dëgjime në auditor; - Vlerësimi me pikë; - Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module; praktikë; - Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; - Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës. <p>Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vizitat nga eperi (Përgjegjës/Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi.²³⁶ Në kushtet e vijimit të procesit akademik online përmes platformave UET LMS dhe Microsoft Teams, sipas Vendimit të Senatit Akademik²³⁷, monitorimi i zhvillimit të leksioneve dhe seminareve është mundësuar nga Zyra e IT në UET nëpërmjet raporteve të vazhdueshme mbi aksesimin e platformave nga stafi akademik/studentët dhe prezencën në mësim, mbi kohëzgjatjen e orëve mësimore, etj. Lidhur me cilësinë dhe metodologjitë e mësimdhënies, orët mësimore janë monitoruar nga Përgjegjësi i Departamentit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>Institucioni kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët.²³⁸</p> <p>Metodat e tërthorta përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve. - Sondazhe: të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit. - Pyetje konceptuale. - Intervista.

²³⁵ Të dhëna për anëtarët e NJSBC (Ref. Nr. 30); Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC (Ref. Nr. 30.4)

²³⁶ G.III.4.1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu (Ref. Nr. 30.8)

²³⁷ Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 (Ref. Nr. 5.1)

²³⁸ G.III.4.2 Formatit i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref. Nr. 40)

	Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesëve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si dhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, të interesuar në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit, sigurohet përmes disa formave të parashikuara në politikat dhe aktet rregullatore të procedurave të brendshme të UET.</p> <p>Një nga këto politika, është ngritja pranë departamenteve e organeve këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës. Po ashtu, përfshirja dhe angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm²³⁹ i përgjigjet nevojës së Universitetit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm.</p> <p>Gjatë periudhës 2016-2019, UET ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në dy projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë: projekti TEMPUS “ENCHASE” dhe projekti Erasmus+ QAINAL.²⁴⁰ Aspektet pozitive të përfshirjes në këto projekte lidhen me shkëmbimin e përvojave, njohja me qasje të reja dhe të ndryshme, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë.²⁴¹</p> <p>Lidhur me sigurimin e cilësisë, ka patur gjithashtu shkëmbime të stafit akademik dhe administrativ – me fokus në mësimdhënie dhe trajnim – në kuadër të projektit Erasmus+ KA1²⁴².</p>

²³⁹ Të dhëna për anëtarët e NJSBC (Ref. Nr. 30); Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC (Ref. Nr. 30.4)

²⁴⁰ Fisha e projektit ENCHASE (Ref. Nr. 30.9); Fisha e projektit QAINAL (Ref. Nr. 30.10)

²⁴¹ Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 (Ref. Nr. 30.3)

²⁴² Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit (Ref. Nr. 43.1)

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në aktet rregullatore të Universitetit.²⁴³ Po ashtu, në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë ka detyrime dhe përgjegjësi konkrete institucionale çdo njësi: departamenti, koordinatori i programit, zyra e karrierës, sekretaria mësimore, stafi akademik.²⁴⁴ Sinkronizimin e veprimtarisë së secilës njësi e garanton KSBC.</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentin që rregullon veprimtarinë lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve të angazhuar²⁴⁵. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës-akademik ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Ky kriter përmbushet duke qënë se në përzgjedhjen e anëtarëve të KSBC, që kryen proceset ciklike të vlerësimit, meren parasysh kriteret e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetencat profesionale; - Paanshmëria; - Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin; - Shkalla e nevojshme e njohjes të anëtarëve të Komisionit; - Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET; - Etj.²⁴⁶ 			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Ky kriter përmbushet nëpërmjet angazhimit të ekspertit të jashtëm në strukturën e KSBC-së, nëpërmjet takimeve me Bordin e Tregut të Punës²⁴⁷. Edhe pjesëmarrjet që UET ka patur në projektet e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë, janë tregues i angazhimit të aktorëve të jashtëm në proceset e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë.²⁴⁸</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="font-size: 2em; font-weight: bold; text-align: center;">X</p>

²⁴³ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)

²⁴⁴ Statuti i UET, Neni 11, 16, 20.5, 20.6 (Ref. Nr. 2); Aneks: Për përcaktimin e detyrave të koordinorit të programit të studimit (Ref. Nr. 36)

²⁴⁵ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)

²⁴⁶ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.7 (Ref. Nr. 8)

²⁴⁷ Të dhëna për anëtarët e NJSBC (Ref. Nr. 30); Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC (Ref. Nr. 30.4); Bordi i Tregut të Punës (Rev. Nr. 12.1)

²⁴⁸ Fisha e projektit ENCHASE (Ref. Nr. 30.9); Fisha e projektit QAinAL (Ref. Nr. 30.10)

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Veprimtarinë e saj KSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një plani calendar, Planit të veprimit, të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet e detajuara dhe raportet përmbledhëse me gjetjet përkatëse.²⁴⁹</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Duke marrë në konsideratë faktin se raportet e KSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat Raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë. Raporti në tërësi i shpërndahet drejtuesëve, ndërsa në departamente diskutohen vetëm ato pjesë të raporteve që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me atë departament. Në ato raste kur të dhënat vlerësohen se kanë një sensibilitet të lartë, rastet trajtohen nga strukturat drejtuese me personin konkret në takime individuale.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Të dhënat e përftuara nga vetëvlerësimet periodike shërbejnë jo vetëm për analizimin e situates por edhe për identifikimin e problematikave me synim marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brendshme. Skedat e pyetësorëve përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i vihen në dispozicion drejtuesëve të Universitetit, si dhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Të dhënat e fituara nga instrumentet e vetëvlerësimeve periodike, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të folloë-up, gjatë të cilit drejtuesit e Universitetit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik²⁵⁰. Në bazë të natyrës së problematikave të evidentuara nëpërmjet pyetësorëve, janë marrë masa, të cilat variojnë nga zhvillimi i seminareve trajnuese dhe deri tek masat konkrete për pedagogët të cilët mund të kenë shfaqur problematikë të vazhdueshme.</p> <p>Në kuadër të politikave të përmirësimit të cilësisë mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme të fokusuar kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies dhe kërkimin shkencor;

²⁴⁹ Plani veprimit KSBC (Ref. Nr. 30.1)

²⁵⁰ G.I.12.1 Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik (Ref. Nr. 41)

	<ul style="list-style-type: none"> - Inkurajimi dhe mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrjen në aktivitete zhvilluese, si brenda ashtu dhe jashtë vendit; - Bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të shkëmbimit të stafit nëpërmjet përfshirjes në programin Erasmus+. 			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet “kontrollit të kryqëzuar” (cross-check) që implementohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm në UET, duke filluar nga njësitë bazë nëpërmjet drejtuesit të departamentit, përgjegjësit të grup-lëndëve²⁵¹ e koordinatorit të programit²⁵², të strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Kurrikulave²⁵³, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.²⁵⁴</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Përfshirja e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë garantohe në mënyrë të drejtpërdrejtë nga përfshirja e tyre në strukturat e garantimit të cilësisë por edhe në mënyrë të tërthortë duke qënë se veprimtaria i bëhet e ditur si stafit akademik ashtu edhe studentëve. Informacioni për studentët shpërndahet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloreve; - Studentëve të përfshirë në struktura të ndryshme brenda institucionit (KSBC, Senatin Akademik); - Këshillit të studentëve; - Javës së orientimit (e cila zhvillohet në fillim të vitit akademik). 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²⁵¹ Statuti i UET, Neni 11, 16, 20.5, 20.6 (Ref. Nr. 2);

²⁵² Aneks: Për përcaktimin e detyrave të koordinatorit të programit të studimit (Ref. Nr. 36)

²⁵³ Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave (Ref. Nr. 13)

²⁵⁴ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Teknologji Informacioni”, me profile: “IT e Biznesit”, “Zhvillim Softwaresh”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh”, “Inovacion”, të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Ofrimi i njohurive në përputhje me nevojat e tregut si edhe me strategjitë e zhvillimit ekonomik të vendit për të ardhmen. Falë studimit të tregut përmes treguesve të ndryshëm të përfshirë nga departamentet përcjellja e njohurive bëhet duke u përshtatur me drejtimit e ecurisë dhe progresit ekonomik të parashikuar duke ofruar kështu punësim të garantuar ose avancim në kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit për studentët e këtij programi studimi.
2. Kualifikimi dhe përvija e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, konsiderohet gjithashtu si një tjetër pikë e fortë e programit ku, falë studimeve në universitete prestigjioze ndërkombëtare të stafit tonë akademik sjellin metodat, literaturën më të fundit dhe përcjellin njohuri në përshtatje me kërkesat e zhvillimit akademik në nivel ndërkombëtar.
3. Zgjerimi i bashkëpunimit kombëtar, ndërkombëtar e marrëdhënive me publikun. Universiteti ynë çdo vit e më tepër zgjeron rrjetin e bashkëpunimeve dhe projekteve në të dyja nivelet duke përmendur këtu jo vetëm shkëmbimet Erasmus, por edhe programet e praktikave me firma mjaft prestigjioze sikurse Mikrotik e Infosoft si edhe shumë të tjera ku e para i certifikon në nivel ndërkombëtar të regjistruarit në programin e saj dhe është marrëveshje e vlefshme për çdo pozicion pune në IT duke i dhënë një garanci dhe një mundësi të artë studentëve tanë.
4. Rritja e mundësive të studentëve nga grupe të përjashtuara për të ndjekur studimet e larta. Universiteti ynë përmban politika rekrutimi studentesh të cilat mbështesin të gjitha shtresat, të gjitha grupet dhe klasat sociale, fetare, shoqërore etj. duke i ofruar mundësinë që të gjithë të jenë të barabartë e të kenë mundësi të njëjta për arsimim të kualifikuar.
5. Infrastruktura e duhur. Për të qënë një universitet i rankuar denjësisht edhe infrastrukturës i kushtohet një vëmendje e veçantë duke investuar vazhdimisht për tu ofruar kushte sa më komode për mësim e studim, por edhe për aktivitetet studentore apo edhe për pjesën e kohës së lirë përmes ambienteve të ndërtuara posaçërisht për qëllimet respektive.
6. Nxitja e aplikimeve për “bursat e ekselencës” si mekanizëm me ndikim të drejtëpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve hyrëse të studentëve. Nëpërmjet fushatës që ndërmerr stafi përmes gjimnaz tour-eve, rrjeteve sociale, njoftimeve në media promovohet mjaft kjo pikë e rëndësishme për të përthithur studentë me mesatare të larta, studentë ekselentë që janë një vlerë e shtuar për emrin e universitetit dhe e përfaqësojnë denjësisht atë gjatë dhe pas studimeve gjithë kohën.
7. Literaturë bashkëkohore. Falë punës në kërkimin shkencor lektorët janë në kontakt me studimet e fundit për tematika të caktuara, hulumtojnë literaturën më të përditësuar duke e përcjellë po ashtu edhe tek studenti vit pas viti.

8. Mësimdhënie bashkëkohore. Stafi pedagogjik falë trajnimeve të herë pas hershme sjell frymën bashkëkohore në mësimdhënie duke përçuar metodikën dhe risitë më të reja në auditorët tona në mënyrë të vazhdueshme për ta afruar sa më tepër studentin me atë në universitetet simotra.
9. Përshtatja e menjëhershme ndaj forcave madhore si në infrastrukturë ashtu dhe në trajnim të pedagogëve për të mundësuar mësimdhënien dhe gjatë pandemisë me Covid-19. Mësimdhënien ka qënë në nivele të kënaqshme duke minimizuar boshlliqet nga mosprezenca në auditorë e studentëve.

Pika të dobëta

1. Mungesa e literaturës referuese në gjuhën shqipe në disa nga lëndët e programit. Meqënëse kjo degë është e re dhe inovacioni zhvillohet me hapa galopantë librat në shqip janë pak të vështirë për tu zotëruar. Ato që janë ekzistues duhen përditësuar kohë pas kohe për tu përshtatur me standartet e fundit. Gjithsesi fakti që njohja e një gjuhe të huaj është detyrim në hyrje, ndihmon në tejkalimin e kësaj problematike.
2. Vështirësia për angazhimin e ekspertëve të fushës për shkak të kufizimeve ligjore. Në fusha të tilla si Informatika dhe Teknologjia e Informacionit është e vështirë të gjenden individ të cilët kanë ndjekur njëkohësisht si karrierën praktike ashtu edhe atë kërkimore dhe akademike. Pavarësisht se individë të caktuar mund të jenë ekspert shumë të mirë, ato nuk mund të angazhohen si titullarë nëse nuk kanë gradë apo titull akademik.
3. Pavarësisht përparimeve në teknologjinë e arsimit global, e implementuar tashmë edhe në UET, si rezultat i ndikimit të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, për disa prej lëndëve me karakter praktik/aplikativ është e nevojshme që të zhvillohen me prezencë në laboratorë, apo auditorë për të arritur cilësinë e nevojshme dhe rezultate optimale në zhvillimin e mësimin.

Lista e dokumenteve mbështetëse për procesin e akreditimit të programit të ciklit të dytë të studimit: Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni”, me profile: “IT e Biznesit”, “Zhvillim Softwaresh”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, “Inovacion”

1. Mendimi i Dekanit
2. Statuti i UET
3. Plani Strategjik UET 2015-2020
 - 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020
 - 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025
 - 3.3 Plani Strategjik UET 2021
4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit
5. Rregullore e UET
 - 5.1 Vendim_Mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe Mbi lëshimin e formave te diplomave
 - 5.2 Rregullore tranzitore_Mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pademisë COVID-19
 - 5.3 Rregullore tranzitore_Per zhvillimin e procesit akademik gjate Vitit Akademik 2020-2021
6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit
7. Rregullore e programit të studimit MSH Teknologji Informacioni
 - 7.1 Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve
 - 7.2 Format i tezës së provimit përfundimtar
8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë
9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore
10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit
 - 10.1. Kalendar akademik 2018-2019
 - 10.2. Kalendar akademik 2019-2020
 - 10.3. Kalendar akademik 2020-2021
11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore
 - 11.1. Shembull thirrje për staf akademik
12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit
 - 12.1. Bordi i Tregut të Punës
 - 12.2. Poster_Panairi i punës 2018 dhe 2019
 - 12.3. Realitetet e Reja të Post-Covid 19 në Tregun e Punës 2020
 - 12.4. Bashkëpunime me biznesin – Projekti 500+
13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave
14. Kurrikula e programit MSH Teknologji Informacioni
 - 14.1. Plani mësimor i programit
 - 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - MSH Teknologji Informacioni
15. Modeli i diplomës (**Urdhëri i aprovimit – nuk ka, pritët akreditimi**); Modeli i Suplementit të Diplomës:
 - 15.1 Model Diplome_Suplement – MSH Teknologji Informacioni_IT e Biznesit
 - 15.2 Model Diplome_Suplement – MSH Teknologji Informacioni_Zhvillim Softwaresh
 - 15.3 Model Diplome_Suplement – MSH Teknologji Informacioni_Inovacion
 - 15.4 Model Diplome_Suplement – MSH Teknologji Informacioni_Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh
16. Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit
17. Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve
18. Adresimi i rekomandimeve të hapjes
19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite
 - 19.1. Format i Syllabusit Cikli i parë dhe dytë

20. CV e stafit akademik të programit të studimit
21. CV e stafit akademik udhëheqës i diplomave (në rastin kur nuk është pjesë e stafit akademik të programit) **(nuk ka)**
22. CV e stafit ndihmës akademik **(nuk ka)**
23. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse
24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit ndër vite (Aneks Tabelat 6; 7; 8; 12)
25. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit (Aneks Tabela 4)
26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse
27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin
 - 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve
 - 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik
28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin
 - 28.1 Mobiliteti i studentëve Erasmus
29. Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve
30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC
 - 30.1. Plani veprimit KSBC
 - 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë
 - 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2020
 - 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC
 - 30.5. Metodologjia e punës së KSBC_Provimet
 - 30.6. Format_Raporti për provimet
 - 30.7. Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset
 - 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu
 - 30.9. Fisha e projektit Enchase
 - 30.10. Fisha e projektit QAinAL
31. Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80/2015), apo Udhëzimeve Kombëtare e Europiane **(nuk kanë dalë ende aktet nga MASR)**
32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale **(informacioni gjendet në Aneks, Tabela 5)**
 - 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale
 - 32.2 B-I-4 Formulari i vetvlersimit të praktikës (nga Studenti)
33. Të dhëna për trajnimet profesionale
 - 33.1 Kalendar i aktivitetëve
34. Marreveshje bashkëpunimi:
 - 34.1 Memorandum bashkëpunimi_UET dhe WE WEB Nr. 123 Prot. Date, 08.05.2017
 - 34.2 Marreveshje bashkëpunimi_UET dhe Infosoft Systems Sh.p.k. Nr. 14 Prot. Date, 23.01.2018
 - 34.3 Marreveshje bashkëpunimi_UET dhe Balfin Sh.p.k Nr. 21 Prot. Date, 31.01.2018
 - 34.4 Marreveshje bashkëpunimi_UET dhe ITD Sh.p.k. Nr. 142 Prot. Date, 05.06.2018
 - 34.5 Memorandum bashkëpunimi_UET dhe MicroTik Academy Nr. 301 Prot. Date, 24.01.2018
 - 34.6 Marreveshje bashkëpunimi_UET dhe Balfin Union Bank Nr. 359 Prot. Date, 03.12.2019
 - 34.7 Marrëveshje bashkëpunimi_UET dhe INSTAT Nr. 14 Prot. Date, 21.01.2019
 - 34.8 Marrëveshje bashkëpunimi_UET dhe The Plaza Tirana Nr. 37 Prot. Date, 19.02.2019
 - 34.9 Memorandum bashkëpunimi_UET dhe EHW Sh.p.k Nr. 40 Prot. Date, 20.02.2019
 - 34.10 Memorandum bashkëpunimi_UET dhe Albtelecom Sh.a. Nr. 358 Prot. Date, 03.12.2019

34.11 Memorandum bashkepunimi_UET dhe Lufthansa Industry Solutions Nr. 360 Prot.
Date, 10.12.2019

34.12 Listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit UET

35. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit
37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve
38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe aftësisë profesionale
39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës
40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët
 - 40.1 D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve
41. G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik
42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit
43. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit akademik
 - 43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit
44. Format Dosje staf akademik (**administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE**):
 - 44.1 Format dosje staf akademik me kohë të plotë
 - 44.2 Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme
45. Inventari i teksteve në fizikë për fushën e programit të studimit
 - 45.1 Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës
 - 45.2 E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë
 - 45.3 Shembull procedure_blerje literature
46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS
 - 46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS
 - 46.2 UET LMS Guide për pedagogun
 - 46.3 UET LMS Guide për studentet
 - 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS/LMS
 - 46.5 Raport: ecuria e mësimin online
47. Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës www.uet.edu.al;
<https://uet.edu.al/new/fakulteti-i-inxhinierise-informatikes-e-arkitektures/>
48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online
49. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1)
50. Të dhëna dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2)
51. Politika e marketingut të programit të studimit
52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës (**Nuk ka – program i ri**)
53. Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”
 - 53.1 VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar
 - 53.2 VKM Nr. 531, datë 11.06.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”
54. UMASR Nr. 666, datë 12.10.2018 “Për riorganizimin e programit MSH Informatikë Ekonomike në MSH Teknologji Informacioni, UET”
 - 54.1 VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 “Për hapjen e UET”
 - 54.2 UMASR Nr. 529, datë 04.09.2018 “Për hapjen e FIJA në UET”
 - 54.3 VBA Nr. 12, datë 07.04.2017 “Për akreditimin institucional të UET”
 - 54.4 VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 “Për akreditimin e UET”
 - 54.5 Certifikatë Akreditimi UET
 - 54.6 Vendim Senati Nr. 18 Prot., datë 17.12.2020 “Mbi mbylljen e disa profileve”
55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)
56. A.II. Kodi i Etikës